



**RAPORTI I MONITORIMIT PËR
SHPËRNDARJEN E NDIHMËS
EKONOMIKE DHE
RESPEKTIMIN E TË DREJTAVE
TË KATEGORISË SË
PERSONAVE ME AFTËSI TË
KUFIZUAR**

Tetor 2019

Tabela e përmbajtjes

Hyrje	3
I. Roli i Njësive të Qeverisjes Vendore	4
I.1 Analiza e të dhënave të mbledhura nga përfaqësuesit e Bashkive Kukës, Elbasan, Librazhd, Fier, Berat dhe Pogradec	5
II. Ofrimi i Ndhmës Ekonomike	14
II.1 Analizë e të dhënave të mbledhura nga intervistimi i grupeve në nevojë në lidhje me ndihmën ekonomike	15
II.2 Problematikat e konstatuara dhe rekomandime	19
III. Respektimi i të drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuar	20
III.1 Analizë e të dhënave të mbledhura nga intervistimi i grupeve në nevojë që i përkasin Personave me Aftësi të Kufizuara (PAK)	21
III.2 Problematikat e konstatuara dhe rekomandime	28

Hyrje

Varfëria është e lidhur me një shumëllojshmëri shkaqesh, duke përfshirë gjendjen e tregut të punës (papunësisë dhe pasivitetit), strukturën e moshës së popullatës, pozitën gjeografike, etnike, nivelin e arsimit dhe faktorë të tjerë. Të dhënat në dispozicion tregojnë se grupet e popullatës që ballafaqohen me rrezik më të lartë të varfërisë janë të papunët, grupet në nevojë, më pak të arsimuarit, personat që jetojnë në zonat rurale dhe ata të angazhuar në bujqësi për nevoja personale.

Zbutja e varfërisë është një çështje shumë më e gjerë se sa vetëm mbrojtja sociale. Politikat e mbrojtjes sociale mund të kontribuojnë në uljen e varfërisë. Në kontekstin e përgjithshëm ekonomik, politikat e punësimit janë vendimtare për uljen e nivelit të varfërisë në Shqipëri. Zbutja e varfërisë nuk lidhet vetëm me pagesat dhe me shërbimet e kujdesit shoqëror, por edhe me një gamë të gjerë politikash të tjera, duke përfshirë, në veçanti ato të lidhura me kujdesin shëndetësor dhe me arsimin.

Qasjet e ndjekura deri me sot, janë bazuar në prioritizimin e grupeve të caktuara, të identifikuara si të rrezikuara apo të pambrojtura. Kjo mund të jetë efektive në përcaktimin e proceseve të koordinimit në nivel kombëtar për këto grupe. Megjithatë, kompleksiteti i përjashtimit mund të orientojë drejt politikave të fragmentuara dhe gjithnjë më pak koherente në kontekstin e rritjes së delegimit/decentralizimit të kompetencave. Kjo çon në fragmentim të mëtejshëm dhe rritje të kostove duke rrezikuar zbatimin e këtyre politikave të mbrojtjes sociale.

Për të pasur një qasje koherente për mbrojtjen sociale, është e nevojshme shënjestrimi i individit në kompleksitetin e nevojave që ka. Një person me aftësi të kufizuara është para së gjithash një fëmijë apo një i rritur me nevoja të veçanta dhe përballet me pengesa njësoj si individët e tjerë të së njëjtës grup moshe. Kjo qasje mundëson hartimin e politikave gjithëpërfshirëse dhe koherente.

Zbutja dhe lehtësimi i varfërisë mundësohet duke siguruar mbulim më të mirë të familjeve dhe individëve të varfër dhe ekstremisht të varfër, rritjen e transparencës dhe shmangien e abuzimeve në skemën e Ndhmës Ekonomike (NE) dhe mbi të gjitha lidhjen me shërbime të integruara dhe skemat e punësimit, me qëllim riintegrimin social të tyre.

Përmirësimi i cilësisë së jetesës së personave me aftësi të kufizuara mund të vijë nëpërmjet vlerësimit bio-psiko-social bazuar në standardet ndërkombëtare të klasifikimit të aftësisë së kufizuar, duke ndërthurur skemën e pagesave në *Cash* me shërbime të integruara, me qëllim integrimin në jetën shoqërore dhe ekonomike.

Bazuar në parimet e decentralizimit dhe deinstitutionalizimit, është e nevojshme zhvillimi i shërbimeve të përkujdesit social për përfshirjen e grupeve në nevojë në programet e Mbrojtjes Sociale. Këto shërbime lidhen me (i) skemën e ndihmës ekonomike dhe aftësisë së kufizuar, (ii) shërbimet e kujdesit shoqëror ekzistuese dhe ato të propozuara dhe (iii) çdo çështje tjetër në fushën e mbrojtjes sociale.

Reformimi i Programit të Mbrojtjes Sociale mund të arrihet nëpërmjet transformimit të Ndhmës Ekonomike në një skemë aktive të riintegrimin social; rishikimin e sistemit të vlerësimit të aftësisë së kufizuar; ndërhyrjes dhe riintegrimin të fëmijëve në familje e komunitet, duke treguar kujdes të veçantë për fëmijët jetimë social dhe biologjikë dhe ofrimin e shërbimeve të integruara.

Prioritet duhet të jetë sigurimi i burimeve të nevojshme për grupet më të rrezikuara nëpërmjet Fondit Kombëtar për Shërbimet Shoqërore dhe Fondeve Rajonale për Shërbimet Shoqërore si pjesë e Fondit Shoqëror. Për këtë është e nevojshme krijimi i sinergjive midis politikave aktive të punësimit dhe përfshirjes sociale, në mënyrë që të gjithë qytetarët shqiptarë të jenë të siguruar, të mbrojtur nga rreziku i rënies në gjendjen e varfërisë përgjatë periudhave aktive dhe joaktive të jetës.

I. Roli i Njësive të Qeverisjes Vendore

Në kuadër të zbatimit të Strategjisë Kombëtare Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2014-2020, organet e qeverisjes vendore kanë të përcaktuara tashmë prioritete të reja në bashkëpunim të ngushtë me organet e qeverisjes qendrore, për thellimin më tej të procesit të decentralizimit në përputhje me parimin e autonomisë vendore.

Mirëqeverisja, transparenca dhe llogaridhënia në menaxhimin e burimeve publike në interes të qytetarëve, rritja e cilësisë së shërbimeve publike që u ofrohet qytetarëve, rritja e pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrje, në kuadër të Rekomandimit 349 (2013) të Kongresit të Autoriteteve Vendore dhe Rajonale të Këshillit të Europës për Qeverinë Shqiptare, janë kërkesa permanente dhe jetike për krijimin e një marrëdhënie të qëndrueshme dhe të besueshme me qytetarët.

Forcimi i demokracisë lokale dhe rajonale nënkupton thellimin e procesit të decentralizimit dhe rritjen e autonomisë të organeve të qeverisjes vendore, shoqëruar këto me një mbështetje më të madhe buxhetore nga qeverisja qendrore, sidomos në kuadër të implementimit të reformës administrativo-territoriale.

Pas miratimit të reformës së re administrative-territoriale, në kuadër dhe të thellimit të procesit të decentralizimit, pushtetit vendor i janë shtuar, ndërmjet të tjerash dhe një sërë kompetencash të reja që kanë të bëjnë me shërbimin social në nivel lokal dhe ndihmën ekonomike.

Por, vihet re se krahas decentralizimit dhe delegimit të këtyre shërbimeve, kompetencat e reja ende nuk janë shoqëruar me financimet e nevojshme përkatëse, si dhe me rishikimin e legjislacionit në fushën e shërbimeve sociale dhe përkujdesin shoqëror. Shërbimet shoqërore që ofrojnë bashkitë për shtresat në nevojë janë në formën e NE, shërbimeve të përkujdesit shoqëror rezidencial dhe komunitar.

Nga ana e Njësive të Qeverisjes Vendore bëhet evidentimi dhe verifikimi i familjeve me probleme sociale dhe sistemimi i tyre në skemën e NE, jepen pagesat e aftësisë së kufizuar, shtesën mujore për invalidët e punës nga fondi i aftësisë së kufizuar etj. Familjet pa të ardhura dhe me të ardhura të pamjaftueshme dhe kategoritë e tjera mund të aplikojnë për përfitimin e NE pranë njësive vendore ku kanë vendbanimin.

Problematikat që janë hasur në vite me pushtetin vendor përsa i përket dhënies së shërbimeve për grupet në nevojë, konkretisht për personat me aftësi të kufizuar dhe dhënien e NE për shtresat në nevojë, kanë patur të bëjnë me:

- Mosdhënien në kohë të pagesave përkatëse, pra pagesës së aftësisë së kufizuar dhe pagesës së NE;

- Ndërprerje të NE;
- Mos zgjidhjen e çështjes së strehimit;
- Identifikimin e nevojave të familjeve që përfshihen në skemën e NE;
- Mungesën e aksesit në transportin urban publik dhe mosrimbursimin e biletës për personat me aftësi të kufizuar;
- Mos parashikimin në buxhet nga ana e organeve të qeverisjes vendore të fondeve të detyruara për të ofruar ndihmë ekonomike edhe jashtë kriterëve për raste të veçanta, si në rastin e familjeve në gjakmarrje.

I.1 Analiza e të dhënave të mbledhura nga përfaqësuesit e Bashkive Kukës, Elbasan, Librazhd, Fier, Berat dhe Pogradec

Në kuadër të iniciativës “Monitorimi dhe promovimi i shpërndarjes së barabartë të të drejtave sociale të grupeve në nevojë në nivel kombëtar dhe lokal (Kukës, Elbasan, Librazhd, Fier, Berat dhe Pogradec)” u zhvillua intervistimi i përfaqësuesve të bashkive të sipërpërmendura në ofrimin e shpërndarjes së ndihmës ekonomike dhe zbatimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuar.

Pyetjet u strukturuan në një mënyrë të tillë për të marrë informacion në lidhje me fondet e disponueshme për NE dhe PAK, nevojën e përmirësimit të këtyre skemave, numrin e familjeve që janë pjesë e tyre, refuzimin, përfitimin nga fondi 6% i bllok-ndihmës ekonomike, punësimin e personave me aftësi të kufizuara, informimin dhe ndërgjegjësimin këtyre kategorive mbi ofrimin e ndihmës ekonomike dhe të drejtat e kategorisë së PAK, pritshmëritë e tyre, kapacitetet e burimeve njerëzore të NJQV-ve, vështirësitë e hasura etj.

Pyetja e parë e shtruar ndaj punonjësve të bashkive në fjalë lidhej me faktin nëse fondi aktual i akorduar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, konsiderohet i mjaftueshëm në raport me nevojat dhe kërkesat e individëve/familjeve për ndihmë ekonomike dhe pagesës për aftësinë e kufizuar. Punonjësit e **Bashkisë Librazhd** në pjesën dërrmuese të tyre deklarojnë se *fondet aktuale në bazë të nevojave që kanë familjarët që përfitojnë ndihmë ekonomike dhe personat me aftësi të kufizuar nuk është i mjaftueshëm, duke marrë parasysh situatën e tyre dhe nivelin e jetesës. Të njëjtin qëndrim shprehin edhe punonjësit e **Bashkisë Kukës** duke deklaruar se *fondi i dhënë për këto kategori është i pamjaftueshëm në krahasim me jetesën e tyre dhe nevojat që duhet të plotësojnë me këtë pagesë. Qëndrim të ndryshëm mbajnë punonjësit e **Bashkisë Elbasan** të cilët deklarojnë se *fondet aktuale për këtë kategori personash konsiderohen të mjaftueshëm, me përjashtim të njërit prej të intervistuarve i cili thekson se duhet shtuar akoma fondi për të plotësuar nevojat e familjeve për ndihmë ekonomike. Punonjësit e **Bashkisë Berat**, njësoj si punonjësit e Bashkisë Kukës dhe Elbasan, thuajse unanimitisht janë shprehur se fondi aktual i akorduar nga Ministria përgjegjëse nuk është i mjaftueshëm në raport me nevojat dhe kërkesat e individëve/familjeve për NE dhe pagesës për aftësinë e kufizuar. Për më tepër ato mendojnë se ky numër është në rritje, duke nënkuptuar se Ndihma Ekonomike në të ardhmen mund të jetë akoma më e pamjaftueshme. Ndërkohë, punonjësit e Bashkive **Pogradec** dhe **Fier** shprehin se fondet e akorduara për këtë kategori janë të mjaftueshëm, me përjashtim të një prej të intervistuarve në Bashkinë **Fier**.***

Në lidhje me zbatimin e ligjit nr.7995, datë 20.9.1995 “Për nxitjen e punësimit”, dhe posaçërisht detyrimin e punëdhënësve për të punësuar persona me aftësi të kufizuar, punonjësit në **Bashkinë Elbasan** deklarojnë se *në këtë njësi vendore janë të punësuar disa persona me aftësi të kufizuar, por konstatohet se nuk kanë dëjani se në çfarë niveli është zbatueshmëria e këtij ligji. Ndërkohë,*

punonjësit e **Bashkisë Librazhd**, në një pjesë të tyre deklarojnë se ky ligj *nuk ka gjetur zbatim*, ndërsa ka nga ato që deklarojnë që niveli i zbatueshmërisë nuk është në nivelin e duhur (në nivel të 40-50%). Punonjësit e **Bashkisë Kukës** deklarojnë të gjithë se ky ligj *nuk ka gjetur zbatim*, madje as në vetë njësinë vendore për shkak edhe të mungesës së infrastrukturës së përshtatshme për personat me aftësi të kufizuara. Në **Bashkinë Berat**, punonjësit në shumicën e tyre shprehin se ky ligj nuk ka gjetur zbatim, ndërsa dy punonjës janë shprehur se zbatueshmëria e tij është tejet e ulët por nuk kanë dhënë shembuj konkretë për këtë. Ndërkohë që punonjësit e **Bashkisë Fier** dhe **Pogradec**, kanë qasje të ndryshme. Punonjësit e **Bashkisë Fier** ndahen midis mendimit se legjislacioni nuk ka gjetur zbatim të plotë dhe midis orientimit optimist se ai po gjen zbatim gjithmonë e më shumë në praktikë por pa dhënë shembuj në praktikë apo shifra mbi këtë situatë. Punonjësit e **Bashkisë Pogradec**, janë të orientuar drejt asaj se legjislacioni ka patur dhe do të ketë impakt mbi punësimin e PAK ku shprehin se *‘Ky ligj ka gjetur zbatim të gjerë në praktikë dhe NjQV-të marrin vazhdimisht masat e duhura për të siguruar zbatimin e tij.’* Një prej të intervistuarve shprehet se *‘Zbatimi i këtij ligji në praktikë në nivel vendor është në rezultate të kënaqshme’*. Por dhe këtu, nuk jepen shifra, shembuj e as masa konkrete që janë marrë nga NjQV në fjalë.

Skema aktuale e ndihmës ekonomike (sistemi i pikëzimit) dhe nevoja për t’u rishikuar dhe përmirësuar në mënyrë që ti përgjigjet më mirë nevojave të qytetarëve, ishte një tjetër pyetje drejtuar punonjësve të gjashtë bashkive. Në **Bashkinë Elbasan** të gjithë punonjësit e intervistuar deklarojnë në mënyrë unanime se *skema aktuale ka nevojë për t’u rishikuar dhe përmirësuar që ti vijë në ndihmë qytetarëve në nevojë*. E njëjta situatë wshtw edhe me punonjësit e **Bashkisë Librazhd** të cilët deklarojnë rishikimin dhe përmirësimin e mëtejshëm të skemës, në mënyrë që të identifikojë qartë familjet në nevojë. Ato theksojnë se ka gjëra që duhen rishikuar *duke vënë prioritet familjet me kryefamiljare femra apo familje shumë të varfra* tw cilat të trajtohen me shuma mbi nivelin e përcaktuar deri më tani si dhe që të *rishikohet dhe të përmirësohet sistemi i pikëzimit*, në mënyrë që të jetë më i qartë dhe transparente për të gjithë qytetarët që përfitojnë ndihmë ekonomike. E njëjta situatë rezulton dhe nga intervistat me punonjësit e **Bashkisë Kukës**, pasi nga intervistat me to vlerësohet se është shumë e rëndësishme që skema aktuale të rishikohet dhe përmirësohet pasi është *mjaft e paqartë dhe penalizuese për shumë familje që kanë me të vërtetë nevojë për ndihmë*. Gjithashtu, sipas tyre duhet të bëhet transparent sistemi i pikëzimit për familjet jo fituese të cilat duhet të kuptojnë arsyen pse nuk janë përfitues. Edhe në **Bashkinë Berat** është e njëjta situatë si në tre bashkitë e sipërpërmendura, të gjithë shprehin për nevojën e rishikimit sepse *skema ka nevojë për rishikime dhe përmirësime në mënyrë që ti përgjigjet më mirë nevojave të qytetarëve*. Ky rishikim nuk shihet në terma të përgjithshëm si nevojë që i përgjigjet evolucionit të vetë kategorisë që e përfiton atë, por lidhet me vlerësimin e përgjithshëm të skemës *‘pasi përbën shkak për padrejtësi në radhwt e personave që kërkojnë të përfitojnë nga skema e NE dhe PAK’*. I njëjti orientim por me cilësime më të përgjithshme, ndahet nga punonjësit e **Bashkisë Fier** ku theksohet se kjo vjen jo vetëm nga konsiderata të natyrës institucionale por edhe *‘Bazuar në ankesat e përfituesve të skemës së NE, mund të them që kjo skemë ka nevojë për rishikime dhe përmirësime në mënyrë që t’u përgjigjet më mirë nevojave të qytetarëve’*. I njëjti shqetësim është edhe tek punonjësit e **Bashkisë Pogradec** të cilët thonë se pamjaftueshmëria e skemës apo përjashtimi që ajo i bën një pjesë të kërkuesve, janë arsyeja kryesore që duhet të çojë në rishikimin e saj. Në të gjashta bashkitë nuk citohen shqetësime konkrete mbi elementë specifikë të skemës apo kritereve që duhen riparë, përveçse në rastin e **Bashkisë Berat**, ku pohohet se skema aktuale lë vend për padrejtësi në trajtimin e PAK.

Sa i përket *numrit të familjeve që trajtohen me ndihmë ekonomike*, janë renditur më poshtë rezultatet sipas bashkive:

- **Bashkia Elbasan** rezulton me 5642 familje;
- **Bashkia Kukës** me 4570 familje;
- **Bashkia Librazhd** me 630 familje;
- **Bashkia Fier** me 580 familje;
- **Bashkia Berat** me 524 familje;
- **Bashkia Pogradec** janë 4131 familje që trajtohen me ndihmën ekonomike, numri i të cilave në secilin njësi vendore reflekton nivelin e varfërisë dhe gjendjen ekonomike të këtyre hapësirave gjeografike.

Në lidhje me numrin e familjeve që i është refuzuar dhënia e ndihmës ekonomike, rezulton se punonjësit e **Bashkisë Kukës** nuk dispononin informacion të saktë, ndërkohë që nga intervistat me punonjësit e **Bashkisë Librazhd** deklaroheshin shifra të ndryshme që lëviznin nga 10 deri në 30 familje. Për **Bashkinë Elbasan**, një pjesë e punonjësve të intervistuar deklarojnë se numri i familjeve që nuk kanë përfituar ndihmë ekonomike për muajin Dhjetor 2018 në **Bashkinë Elbasan** është 290 familje. Ajo çfarë konstatohet nga intervistat me punonjësit e tre bashkive të sipërpërmendura është mungesa e të dhënave të sakta në lidhje me numrin e familjeve që i është refuzuar ndihma ekonomike.

Duke vijuar me **Bashkinë Berat**, janë 225 familje që i është refuzuar ndihma ekonomike; në **Bashkinë Fier** janë 580 familje dhe në **Bashkinë Pogradec** janë 334 familje që i është refuzuar ndihma ekonomike.

Përfitimi nga fondi 6% i bllok-ndihmës, ishte një tjetër pyetje drejtuar përfaqësuesve të të gjashta bashkive të sipërpërmendura, nga ku rezultoi se në **Bashkinë Elbasan** numri i familjeve që kanë përfituar ndihmë ekonomike nga fondi 6% për muajin dhjetor 2018 është 145 familje; në **Bashkinë Librazhd** ky numër shkante maksimalisht në 46 familje, në **Bashkinë Kukës** numri i familjeve përfituese nga fondi 6% i bllok-ndihmës është rreth 287 familje. Në **Bashkinë Berat**, 64 familje përfitojnë nga fondi bllok i ndihmës 6%. Në **Bashkinë Fier e Pogradec**, përkatësisht trajtohen 46 dhe 122 familje.

Për numrin e personave përfitues të pagesës së aftësisë së kufizuar, rezultatet janë si vijojnë:

- **Bashkia Elbasan** rezulton me 5521 persona me aftësi të kufizuara (PAK, të Verbër dhe paraplegjik); 1050 persona të tjerë të cilët janë kujdestarë të këtyre personave me aftësi të kufizuara;
- **Bashkia Librazhd** numri i përfituesve të pagesës së aftësisë së kufizuar shkon në 234 persona;
- **Bashkia Kukës** janë 198 persona që trajtohen me pagesën e paaftësisë;
- **Bashkia Berat** janë 2000 persona që përfitojnë pagesën e aftësisë së kufizuar;
- **Bashkia Fier** janë 3011 persona;
- **Bashkinë Pogradec** janë 2612 persona.

Ndërkohë që në lidhje me faktin se sa invalidë pune përfitojnë shtesën në pensionin e invaliditetit, si përfitim paaftësie, rezultojnë këto të dhëna:

- në **Bashkinë Elbasan** për muajin janar 2019 janë 3836 persona me shtesën e pensionit të invaliditetit;
- në **Bashkinë Librazhd** rezultojnë 236 invalide pune;
- në **Bashkinë Kukës** janë 140 persona.

Ajo çfarë konstatohet përsëri nga intervistat me punonjësit e tre bashkive të sipërpërmenduar është mungesa e të dhënave të sakta apo dhe kontradiktore, në lidhje me numrin e invalidëve të punës që përfitojnë shtesën në pensionin e invaliditetit.

- Në **Bashkinë Berat** janë 1500 invalide pune;
- Në **Bashkinë Fier** janë 3020 individë pune;

- Në **Bashkinë Pogradec** janë 2114 invalidë pune që përfitojnë shtesën në pensionin e invaliditetit.

Informimi dhe orientimi i kësaj kategorie me qëllim përfitimin e shërbimeve të garantuara me ligj, ishte një tjetër pyetje e rëndësishme për të cilën u dhanë këto përgjigje nga punonjësit e gjashtë bashkive:

- ✓ Në **Bashkinë Elbasan** vlerësojnë se kjo kategori është mjaftueshëm e informuar dhe e orientuar me qëllim përfitimin e shërbimeve të garantuara me ligj; bashkia bën takime ndërgjegjësuese, shpërndan materiale informuese, etj; janë të mirëinformuar pasi marrin në çdo kohë informacione pranë zyrave përkatëse;
- ✓ Në **Bashkinë Librazhd** vlerësojnë se kjo kategori është e informuar pasi aksesueshmëria e ligjit është e shfaqur kudo; organizohen fushata ndërgjegjësuese edhe nga organizatat jofitimprurëse; punonjësit e bashkisë gjithmonë janë të gatshëm për të informuar të gjithë qytetarët e kësaj kategorie; në këndin e informacionit janë të afishuara të gjitha informacionet e nevojshme. Gjithsesi, gjykohet se është e nevojshme që të rritet më tej niveli i informimit dhe se problem mund të jenë familjet që janë në zonat e largëta;
- ✓ Në **Bashkinë Kukës** vlerësojnë se kjo kategori është e informuar mbi shërbimet, kriteret, problematikat etj; janë organizuar takime informuese; familjet që kërkojnë të aplikojnë, marrin një informacion të detajuar mbi ligjin nga specialistët e ndihmës ekonomike dhe PAK. Megjithatë, theksohet nevoja për të ndërruar në mënyrë të vazhdueshme fushata informuese për shërbimet në komunitet.
- ✓ Në **Bashkinë Berat** vihet re një bashkërendim i pjesshëm i përgjigjeve të cilat tregojnë se kjo kategori është mjaftueshëm e informuar me qëllim përfitimin e shërbimeve të garantuara me ligj. Informacioni i kategorisë është kryer duke organizuar e zhvilluar takime dhe dëgjesa publike të cilat kanë si qëllim përfitimin e shërbimeve të garantuara me ligj. Vetëm në një rast një prej të intervistuarve shprehet se kjo kategori është pak e informuar mbi kuadrin ligjor dhe kriteret e përfitimit të NE dhe pagesës së aftësisë së kufizuar;
- ✓ Në **Bashkinë Fier** në masën më të madhe të të intervistuarve vlerësohet se kategoria në fjalë është mjaft e informuar me qëllim përfitimin e shërbimeve të garantuara me ligj. Vetëm njëri prej të intervistuarve pohon të kundërtën, ku vlerësohet se kategoria nuk është mjaftueshëm e informuar dhe orientuar me qëllim përfitimin e shërbimeve të garantuara me ligj;
- ✓ Në **Bashkinë Pogradec** punonjësit ndahen mes pamjaftueshmërisë dhe informimit të mjaftueshëm të kategorisë për përfitimet që mundëson ligji.

Në lidhje me pyetjen nëse respektohet parimi i transparencës, barazisë dhe meritës në shpërndarjen e fondeve publike për shërbimet sociale që lidhen me ofrimin e ndihmës ekonomike dhe pagesën për aftësinë e kufizuar, rezultojnë këto të dhëna: në **Bashkinë Elbasan** vlerësohet se respektohet parimi i transparencës, barazisë dhe meritës; afishohen listat e përfituesve dhe nuk janë hasur problematika në këtë drejtim. Në **Bashkinë Librazhd** në pjesën dërrmuese vlerësohet se sistemi elektronik siguron transparencë dhe barazi për të gjithë dhe ndihma ekonomike shpërndahet tek ato familje që kanë më shumë nevojë; çdo gjë po bëhet transparente me anë të sistemit; dhënia e ndihmës ekonomike është mjaft transparente dhe shënjestron familjet më në nevojë. Ndërkohë që ka dhe deklarime që theksojnë faktin se, nuk respektohet parimi i barazisë, transparencës dhe meritës në shpërndarjen e fondeve publike për shërbimet sociale, gjithmonë ka qytetarë të pakënaqur si dhe në lidhje me ofrimin e shërbimeve nuk përfitojnë të gjitha ato familje që realisht kanë nevojë; në **Bashkinë Kukës** vlerësojnë se shpërndarja e fondeve bëhet në përputhje me ligjin si dhe çdo vendim bëhet publike për të qënë sa më transparent; nga ana e personave përgjegjës çdo muaj publikohen listat e personave përfitues; çdo gjë bëhet publike dhe është e evidentueshme

*se cilët persona trajtohen me ndihmë. Nga ana tjetër ka dhe mendime të kundërta që deklarojnë se nuk zbatohet ligji i transparencës për qytetarët për aq kohë sa pikëzimi është i pa kuptueshëm për punonjësit e ndihmës ekonomike e si rrjedhojë edhe për qytetarët. Në **Bashkinë Fier** ‘parimi i transparencës, barazisë dhe meritës janë plotësisht të zbatueshme’. Në **Bashkinë Berat**, tetë prej të intervistuarve pohojnë se ‘parimet e lartpërmendura respektohen në shpërndarjen e fondeve publike për shërbimet sociale që lidhen me ofrimin e NE dhe pagesës për aftësinë e kufizuar’, ndërsa në dy raste mohohet se parimet e transparencës, barazisë dhe meritës respektohen. Ndërkohë që për punonjësit e **Bashkisë Pogradec**, pohojnë se të gjitha parimet e lartpërmendura respektohen plotësisht, por pa dhënë shembull të qartë mbi këtë.*

Pritshmëritë e tjera që kanë qytetarët që janë në skemën e ndihmës ekonomike dhe pagesës së aftësisë së kufizuar kundrejt NJQV, ishte një pyetje tjetër për punonjësit e bashkive, nga ku rezultoi se: në **Bashkinë Elbasan** sipas përgjigjeve të dhëna qytetarët kërkojnë rritje të pagesës së ndihmës ekonomike ose pagesës së aftësisë së kufizuar; të ndryshohet ligji për aftësinë e kufizuar ku të hiqet elementi i viteve të punës të siguruara pasi nuk fitojnë as tek sigurimet shoqërore nëse nuk kanë një vit siguracion shoqëror në 5 vitet e fundit; përmirësimi i infrastrukturës të përshtatshme për personat me aftësi të kufizuara; të hiqet afati i rikomisionimit, të bëhet përgjithmonë për personat me aftësi të kufizuar që vuajnë nga sëmundje kronike të pashërueshme; mospërfshirjen në pagesën e disa taksave. Në **Bashkinë Librazhd** nga përgjigjet e dhëna rezultoi se nga qytetarët kërkohet lehtësim i procedurave; rritjes së masës së përfutimit të ndihmës ekonomike dhe PAK si dhe të minimizohen burokracitë; përmirësimin e kushteve të jetesës dhe përmirësimi i shërbimeve; rimbursimi i faturave të transportit për PAK; përgjysmimi i taksave; rishikimi i sistemit të pikëzimit për NE etj. Në **Bashkinë Kukës** konstatohet se pritshmëritë e qytetarëve fokusohen në rritjen e pagesës së ndihmës ekonomike dhe pagesës së paaftësisë; lehtësimin e procedurave si dhe punësimin; të jenë pjesë e skemës së ndihmës ekonomike (qytetarëve që i është refuzuar kjo e drejtë). Në **Bashkinë Fier** vlerësimet ndahen në mënyrë të barabartë mes nevojës së lehtësimit të procedurave të skemës NE dhe rritjen e ndihmës ekonomike, pasi ajo gjykohej e pamjaftueshme. Në **Bashkinë Berat**, pritshmëritë sipas punonjësve të intervistuar nuk lidhen vetëm me rritjen e NE por dhe me zgjerimin e llojeve të shërbimeve falas që vetë Bashkia duhet të ofrojë për PAK ‘Qytetarët presin rritje të shumës së përfutimit dhe ofrimin e shërbimeve falas nga ana e bashkisë.’ Shqetësimet e qytetarëve që përfitojnë nga NE në **Bashkinë e Pogradecit**, përtej rritjes së NE, kërkojnë dhe ulje të taksave ndërkohë që prej punonjësve të intervistuar shprehen se ‘Qytetarët kryesisht janë të kënaqur lidhur me punën e NJQV-ve por ne vazhdimisht sigurohemi që të adresojmë të gjitha shqetësimet dhe pritshmëritë e tyre’.

Pjesë e rëndësishme e Njësive të Qeverisjes Vendore është informimi dhe orientimi i grupeve potenciale për përfitimin e ndihmës ekonomike dhe pagesën për aftësinë e kufizuar. Në këtë aspekt, për pyetjen se çfarë veprimtarish konkrete ka ndërmarrë Bashkia për të informuar dhe orientuar qytetarët, punonjësit e bashkive dhanë këto përgjigje:

- Në **Bashkinë Elbasan** veprimet konkrete lidhen me faktin se për familjet të cilat kërkojnë të trajtohen me ndihmë ekonomike dhe nuk kanë mundësi të aplikojnë në sistem për arsye të ndryshme, Bashkia ka akorduar një fond të veçantë për këto familje nga të ardhurat e veta; për personat të cilët identifikohen ose dyshohen si persona me probleme shëndetësore referohen tek specialisti për personat me PAK në Bashki që të asistojë personin në kryerjen e procedurave ligjore për përfitimin e pagesës së paaftësisë; takime, fushata sensibilizuese, fletëpalosje, informacion në media etj.
- Në **Bashkinë Librazhd** veprimet e ndërmarra nga kjo njësi vendore kanë të bëjnë me zbatimin e projekteve të ndryshme që kanë në fokus grupet në nevojë për informimin e tyre

lidhur me shërbimet që përfitojnë; takime ndërgjegjësuese dhe lajmërimi pranë zyrave të ndihmës ekonomike; ditë të hapura me grupet në nevojë; nëpërmjet sporteveve one stop shop, kryerjen e orientimit dhe informimit për shërbimet që përfitojnë qytetarët dhe problematikat që ato hasin; vlerë e shtuar janë edhe OJF që nëpërmjet zbatimit të projekteve informojnë dhe edukojnë të gjithë qytetarët lidhur me NE dhe të drejtat e personave aftësi të kufizuara.

- Në **Bashkinë Kukës** veprimtaria e kësaj njësie vendore për informimin dhe orientimin e grupeve potenciale për përfitimin e ndihmës ekonomike dhe pagesën për aftësinë e kufizuar është fokusuar kryesisht në *takime dhe sesione informuese (ndihmë në këtë aspekt kanë dhënë edhe OJF-të që kanë zbatuar projekte që kanë patur në fokus informimin e grupeve në nevojë lidhur me shërbimet që përfitojnë)*; çdo muaj personat e interesuar informohen pranë administratorëve social dhe atyre të PAK duke u paraqitur vetë por dhe duke u njoftuar nëpërmjet numrave të kontaktit. Për ndihmën ekonomike është e detyrueshme që kryefamiljarët të paraqiten çdo muaj pranë administratorit social.
- Në **Bashkinë Berat** vihet re një bashkërendim i pjesshëm i përgjigjeve të cilat tregojnë se kjo kategori është mjaftueshëm e informuar me qëllim përfitimin e shërbimeve të garantuara me ligj. Informacioni i kategorisë është kryer duke organizuar e zhvilluar *takime dhe dëgjesa publike të cilat kanë si qëllim përfitimin e shërbimeve të garantuara me ligj*. Vetëm në një rast një prej të intervistuarve shprehet se kjo kategori është pak e informuar mbi kuadrin ligjor dhe kriteret e përfitimit të NE dhe pagesës së aftësisë së kufizuar;
- Në **Bashkinë Fier** në masën më të madhe të të intervistuarve vlerësohet se kategoria në fjalë është mjaft e informuar me qëllim përfitimin e shërbimeve të garantuara me ligj. Vetëm njëri prej të intervistuarve pohon të kundërtën, ku vlerësohet se kategoria nuk është mjaftueshëm e informuar dhe orientuar me qëllim përfitimin e shërbimeve të garantuara me ligj;
- Në **Bashkinë Pogradec**, punonjësit ndahen mes pamjaftueshmërisë dhe informimit të mjaftueshëm të kategorisë për përfitimet që mundëson ligji.

Një pyetje tjetër lidhet me faktin nëse Bashkia disponon kapacitetet e mjaftueshme njerëzore, me qëllim ushtrimin e përgjegjësive përkatëse në ofrimin e ndihmës ekonomike dhe pagesës së aftësisë së kufizuar. Për këtë pyetje, punonjësit e bashkive dhanë përgjigjet si vijon:

- Për **Bashkinë Elbasan** theksohet se *disponon kapacitetet e mjaftueshme dhe personel të specializuar për ushtrimin e përgjegjësive përkatëse*;
- Për **Bashkinë Librazhd** deklarohet se *nuk ka kapacitetet e mjaftueshme për të përballuar fluksin e qytetarëve në nevojë dhe shërbimet që përfitojnë*;
- Për **Bashkinë Kukës**, sipas punonjësve të intervistuar, deklarohet se kjo njësi vendore *disponon kapacitetet e mjaftueshme për të adresuar çështjet që lidhen me menaxhimin e ndihmës ekonomike dhe pagesës së aftësisë*.
- Për **Bashkinë Fier**, gjykohet se institucioni disponon mjaftueshëm kapacitete njerëzore *'me qëllim ushtrimin e përgjegjësive në ofrimin e NE dhe pagesës së aftësisë së kufizuar'*. Vetëm një prej të intervistuarve shprehet për të kundërtën.
- Për **Bashkinë Berat**, po kështu përgjigjet janë në masën dërrmuese pozitive ku mendohet se *'bashkia disponon kapacitetet e mjaftueshme njerëzore dhe me arsimin përkatës'*. Elementi i arsimit dhe kualifikimit vihet në dukje në raport me aftësitë që ka NjQV për tu përballur me shpërndarjen e NE.
- Për **Bashkinë Pogradec**, punonjësit e intervistuar janë ndarë në dy grupe, ku në një anë pohohet se Bashkia disponon të gjitha burimet e nevojshme njerëzore në lidhje me përgjegjësitë mbi shpërndarjen e NE dhe asistencën ndaj PAK ndërkohë që në tjetrën

pohohet e kundërta ku *'Bashkia nuk disponon kapacitetet e mjaftueshme njerëzore për ushtrimin e përgjegjësive përkatëse në ofrimin e këtyre shërbimeve'*.

Vështirësitë e mundshme që hasin strukturat përgjegjëse të Njësive të Qeverisjes Vendore gjatë punës së tyre të përditshme, në lidhje me skemën e ofrimit të ndihmës ekonomike dhe pagesës së aftësisë së kufizuar, ishte një tjetër pyetje drejtuar punonjësve të gjashtë bashkive në fjalë. Bazuar në përgjigjet e dhëna rezultoi se: vështirësitë e hasura në **Bashkinë Elbasan** lidhen me *mangësi në të kuptuarit nga ana e personave pretendues apo përfitues të ndihmës ekonomike lidhur kjo edhe me nivelin e ulët arsimor; probleme në funksionimin e sistemit elektronik të aplikimit të ndihmës ekonomike; infrastruktura jo e përshtatshme për kategorinë PAK; sistemi është shumë i rënduar dhe aplikimi zgjat më shumë se 30 minuta; vështirësi gjatë komunikimit me personat me aftësi të kufizuar për shkak të nivelit të tyre arsimor/shëndetësor për të kuptuar legjislacionin në fuqi. Në **Bashkinë Librazhd** vështirësitë lidhen me sistemin online pasi nuk është i qëndrueshëm, gjë që pengon punën dhe krijon rradhë dhe vonesa; mbingarkesën e dokumentacioneve dhe qytetarët të painformuar; vështirësitë që hasen nga ndihma ekonomike dhe kjo vjen si pasojë e sistemit të pikëzimit; mungesë burimesh njerëzore në strukturat që merren me këto çështje etj. Ndërkohë që për **Bashkinë Kukës, përveç arsytet e lartpërmenduar, theksohen në mënyrë të veçantë vështirësitë e personave përgjegjës lidhur me verifikimin në terren të familjeve në nevojë dhe ajo që është më e evidente lidhet me përballjen çdo ditë me familjet të cilat nuk përfitojnë nga skema dhe që me të drejtë kërkojnë të informohen për arsyen e përjashtimit por që administratorët nuk mundën t'u kthejnë përgjigje pasi nuk kanë akses në sistemin e pikëzimit. Në **Bashkinë Fier**, vështirësitë lidhen me njohuritë e kufizuara që punonjësit kanë për kuadrin e ri ligjor si duke marrë parasysh individët që punojnë në këto zyra si strukturat në tërësi. Këtu problemi haset tek vështirësia e plotësimit të dokumenteve si dhe tek niveli i ulët i besimit që kanë qytetarët; në **Bashkinë Berat**, problemet e hasura janë dy, ato të natyrës ligjore dhe strukturore. Në raport me problematikat ligjore, ato thonë se pengesat që sjell ligji për sigurimet shoqërore kanë rritur ndjeshëm numrin e kërkuësve për t'u trajtuar si PAK. Vështirësitë e tjera janë të natyrës infrastrukturore pasi sistemi online punon me vështirësi dhe shumë ngadalë; në **Bashkinë Pogradec**, vështirësitë kanë të bëjnë me formimin e punonjësve në njohjen dhe zbatimin e kuadrit ligjor dhe me formimin e tyre profesional. Këtu pohohet se nuk njihet mjaftueshëm ligji pasi ka vështirësi në kuptimin e tij gjë që rrjedh nga mungesa e arsimimit të duhur të punonjësve përgjegjës për këtë sektor. Kjo sjell dhe mungesën e informacionit për qytetarët, gjë që ndikon më pas në boshllëqe në hartimin e dokumentacionit të kërkuar.***

Në vijim të pyetjes së mësipërme, punonjësve të bashkive iu kërkua opinioni i tyre në lidhje me problematikat dhe vështirësitë kryesore që hasin qytetarët gjatë procesit të aplikimit në skemën e ndihmës ekonomike dhe pagesën për aftësinë e kufizuar, nga ku rezultuan këto përgjigje për secilën nga bashkitë:

- ✓ Për **Bashkinë Elbasan** qytetarët nuk kanë vështirësi, me përjashtim të rasteve kur nuk punon sistemi, ndërkohë që pranojnë se në disa raste mungon ofrimi i shërbimit për shkak të problemeve me sistemin si dhe punësimi i një anëtari të familjes e përjashton nga skema të gjithë familjen.
- ✓ Për **Bashkinë Librazhd**, punonjësit kanë dhënë përgjigje të ndryshme. Një pjesë theksojnë se nuk ka problematika, pasi edhe në ato hapësira kur qytetarët nuk janë të qartë, kanë ndihmën e punonjësve të bashkisë si dhe orientimin e duhur; procesi i aplikimit për ndihmë ekonomike është thjeshtëzuar shumë dhe dokumentat që duhet të paraqesin qytetarët janë minimizuar; gjatë aplikimit për ndihmë ekonomike nuk ka asnjë pengesë nëse dokumentet janë në rregull. Ndërkohë që një pjesë e të intervistuarve deklarojnë problematika dhe vështirësi që lidhen kryesisht me mosdeklarimin e saktë të gjendjes social-ekonomike,

mosdeklarimi i pensioneve dhe i siguracioneve; vështirësitë për personat me aftësi të kufizuara në atë që duhet të shkojnë për të kryer kontrollet e nevojshme dhe shpeshherë nuk gjejnë mjekun pasi është në vizita të tjera; vështirësitë që kanë qytetarët me pagesën e aftësisë së kufizuar në lidhje me komisionimet ku qytetarët ndeshen me informalitet dhe parregullsi për të vazhduar me marrjen e pagesës së aftësisë së kufizuar; qytetarët nuk e kanë të qartë mënyrën e plotësimit të formularit.

- ✓ Në përgjigjet e dhëna nga punonjësit e **Bashkisë Kukës** theksohet se problemet lidhen me faktin se pyetjet kërkojnë përgjigje shumë fikse dhe nuk tolerojnë fare hamendësime; mosdeklarimi i të dhënave të sakta; ngarkimi i dokumentave si dhe plotësimi në mënyrë të pasaktë të formularit, që i skualifikon nga sistemi i pikëzimit; mënyra e deklarimit pasi intervista në mjaft pyetje të tij nuk është shumë e qartë dhe i kuptueshëm nga ana e qytetarëve.
- ✓ Në **Bashkinë Fier**, problemet lidhen me plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm për të përfutur nga skema NE. Tjetër element është ai i vështirësive që vetë administrata ka për të sqaruar qytetarët e që sjell më pas një ulje të nivelit të besueshmërisë të vetë njërive vendore.
- ✓ Për **Bashkinë Berat**, problemet lidhen me vështirësi të tipit infrastrukturor, që vijnë nga performanca jo e mirë e sistemit e që i detyron qytetarët të presin në rradhë të gjata. Përpos kësaj, qytetarët kanë vështirësi për të plotësuar dokumentet e për më tepër, kriteret që parashikon skema për tu kualifikuar për përfitim në kuadrin e NE i detyrojnë ata të bëjnë ekzaminime të specializuara të cilat nuk ofrohen nga sistemi shëndetësor vendor e as nga struktura private lokale. Kjo detyron kandidatët që ti kryejnë ato në Tiranë, gjë që nënkupton një farë qarku vicioz, ku për të marrë ndihmë kandidatët duhet të shpenzojnë paraprakisht shuma parash të cilat ndoshta ata nuk i disponojnë.
- ✓ Në **Bashkinë Pogradec**, pavarësisht se në pyetjen mbi mjetet e mekanizmave të përdorur nga Bashkia për informimin e PAK dhe përfituesve të NE, listoheshin një sërë iniciativash, problemi kryesor qëndron tek paaftësia e kandidatëve për përfitim nga NE, të plotësojnë dokumentacionin e nevojshëm si dhe informacionin e pamjaftueshëm që ato kanë në lidhje me procesin. Sidomos mungesa e informacionit listohet si problem kryesor që qytetarët hasin, e për pasojë administrata, në përpilimin e dokumentacionit.

Për të kuptuar më mirë të gjithë panoramën dhe situatën e grupeve në nevojë, ishte e rëndësishme të dihej se cilat nga kriteret ligjore të parashikuara janë kriteret më të hasura që përjashtojnë qytetarët nga përfitimi i ndihmës ekonomike dhe pagesa për aftësinë e kufizuar. Në lidhje me këtë pyetje, përgjigjet e përftuara nga përfaqësuesit e bashkive ishin si vijon: Sipas **Bashkisë Elbasan** familjet refuzohen nga skema e ndihmës ekonomike pasi nuk marrin pikët e mjaftueshme, nuk paraqiten tek Zyra e Punës ose refuzojnë programet e nxitjes së punësimit, nuk paraqiten për të bërë deklarin tre mujor, fillojnë punë, bëjnë deklarin të rremë; personat me aftësi të kufizuara përjashtohen nga pagesa kur personi ka vite pune, kur diagnoza e pacientit nuk përbën objekt përfitimi për pagesë aftësie të kufizuar, si dhe kanë diagnoza të veçanta të cilët kanë një limit përfitimi. Për **Bashkinë Librazhd** kriteret ligjore që përjashtojnë qytetarët janë ato që kanë të bëjnë me disponimin e mjeteve motorrike, biznese, apo të qënurit të punësuar; kriteri ligjor që më së shumti i përjashton qytetarët nga përfitimi i ndihmës ekonomike është paraqitja çdo tre muaj e të gjithë anëtarëve madhore pranë administratorëve të NE; ndërprerja e pagesës së aftësisë së kufizuar për mos dorëzimin prej përfituesve të formularit vjetor mjekësor të plotësuar nga mjeku specialist deri në 30 ditë kalendarike pas datës së përcaktuar për dorëzimin e tij, penalizimi i shumë individëve për mospërfitim në rast se individit ka derdhur kontribute ose ka vite të siguruara para sëmundjes. Sipas përfaqësuesve të **Bashkisë Kukës** kriteret ligjore që përjashtojnë më së shumti qytetarët nga përfitimi i ndihmës ekonomike dhe pagesa për aftësinë e kufizuar lidhen me

*deklarimin e mjeteve motorrike, kontributet e paguara më herët, punësimi i një prej anëtarëve të familjes, mos regjistrimi në Zyrën e Punës, problemet me aktshitetet e makinave etj; mos deklarimi i të dhënave të sakta i cili bëhet shkak për penalizimin nga sistemi i pikëzimit. Në **Bashkinë Fier**, skualifikimet ndodhin për shkak të deklarimit të rremë të të dhënave, ndërkohë që vetëm një nga të intervistuarit e lidh skualifikimin me përfitime të tjera paralele si ato nga Sigurimet Shoqërore apo pasja e një certifikate pronësie. Në të njëjtën linjë, janë dhe përgjigjet e punonjësve të **Bashkisë Pogradec**, ku kriteri i skualifikimit mbetet deklarimi i rremë i të dhënave. Në **Bashkinë Berat**, skualifikimi ndodh rëndom për arsye të mospasjes së 1 vit pune nga 5 vitet e fundit të pasiguruara si dhe me refuzimin e punësimit.*

Një pyetje tjetër e parashtruar kishte të bënte me ekzistencën ose jo të mekanizmave të aksesueshëm ankimimi në mënyrë që qytetarët të denoncojnë problemet e tyre lidhur me skemën e ndihmës ekonomike dhe pagesën për aftësinë e kufizuar.

- ✓ Në **Bashkinë Elbasan**, punonjësit e intervistuar deklarojnë se ekzistojnë këto mekanizma, duke përmendur ndryshimet e fundit të bëra në sistemin e ndihmës ekonomike; Zyrën me Një Ndalesë; si dhe ankimimin që bëhet pranë Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Elbasan dhe pranë drejtorisë përkatëse në bashki.
- ✓ Të njëjtën përgjigje pozitive deklarojnë edhe të intervistuarit në **Bashkinë Librazhd**, duke theksuar faktin e ekzistencës së sporteve apo sekretarive pranë çdo njësie ku qytetarët kanë të drejtë të kundërshtojnë çdo padrejtësi që mendojnë se i është bërë si edhe të kërkojnë të drejtën e tyre. Është e parashikuar në ligj që për çdo vendim negativ që i vjen qytetarit, ai ka të drejtë të kërkojë të drejtën e tij brenda 10 ditëve nga data e vendimit për NE apo përfitim për paaftësi të kufizuara që sipas tyre të mohuar, fillimisht duke iu drejtuar pranë Administratorëve të NE, Drejtorinë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror ose ankimimin e vendimit në Gjykatë.
- ✓ Edhe të intervistuarit e **Bashkisë Kukës** konfirmojnë ekzistencën e mekanizmave ankimues duke përmendur si argument faktin që çdo i interesuar sapo të paraqitet pranë punonjësve ka të drejtën dhe merr informacionin që i nevojitet. Por nga përgjigjet e dhëna nuk përmenden se kush janë konkretisht këto mekanizma ankimues dhe si qytetarët mund tu drejtohen atyre.
- ✓ Në **Bashkinë Fier**, punonjësit shprehen mbi ekzistencën e mekanizmave të ankimit e që janë të aksesueshëm nga qytetarët, ku theksohet ankimimi nëpërmjet sistemit online si dhe kërkesa me shkrim pranë Bashkisë për të sqaruar refuzimin nga sistemi e që pasohet nga kthimi i përgjigjes po me shkrim.
- ✓ Në **Bashkinë Berat**, punonjësit janë me specifike e përmendin zyrat me një ndalesë, sistemi i ankesave në Drejtorinë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror D.R.S.SH si dhe ato në portal. Po kështu ato shprehen se kërkesat mund tu drejtohen bashkive, zyrave rajonale apo ministrisë përkatëse.
- ✓ Në të njëjtën linjë përgjigjen dhe punonjësit e **Bashkisë Pogradec**, të cilët listojnë sistemin e ankimit online e që është plotësisht i aksesueshëm për qytetarët.

Pyetja e fundit adresuar punonjësve të gjashtë bashkive kishte të bënte me ankesat në lidhje me skemën e ndihmës ekonomike dhe si ato janë adresuar nga strukturat përkatëse të njëjësive të qeverisjes vendore.

- ✓ Në **Bashkinë Elbasan**, deklarojnë se ka patur ankesa. Këto ankesa, fillimisht janë sqaruar nga strukturat përkatëse të ndihmës ekonomike në Bashkinë Elbasan. Nëse personi ka insistuar, është adresuar rasti tek Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Elbasan. Theksohet se shumica e rasteve kanë gjetur zgjidhjen e duhur nga institucionet përkatëse, por nuk deklarohet ndonjë shifër konkrete.

- ✓ Në **Bashkinë Librazhd** konfirmohet gjithashtu fakti që ka pasur ankesa të ndryshme, sidomos nga ato që nuk përfitojnë NE (sistemi i pikezimit) të cilat, janë trajtuar nga zyra e NE në bashkëpunim dhe me DRSHSSH, duke u përpjekur që të jepen zgjidhjet e duhura. Në bazën e këtyre ankesave, është duke u punuar me sistemin dhe me ligjin nga organet përkatëse, në mënyrë që të shkohet drejt standartizimit dhe parimit meritë-përfitim.
- ✓ Në **Bashkinë Kukës** deklarohet se ka pasur ankesa të pafundme dhe se ato janë trajtuar në kohën dhe mënyrën e duhur. Theksohet se ka pasur mjaft ankesa lidhur me mos përfitimin e ndihmës ekonomike të cilat janë adresuar në të gjitha nivelet që nga administratori social përgjegjës, drejtorisë përkatëse në Bashki, Shërbimin Social Shtetëror Rajonal dhe deri në instancat gjyqësore.
- ✓ Në **Bashkinë Fier**, pohohet se ka patur ankesa që janë adresuar në kohë nga strukturat përgjegjëse. Një prej përgjigjeve tregon se ankesat janë dërguar në mënyrë elektronike përmes portalit. Të intervistuarit nuk japin të dhëna specifike nëse këto ankesa janë bërë me shkrim dhe online e të gjitha janë adresuar në kohë, e as për raste të veçanta, si mbi sasinë e natyrën e ankesave e as me mënyrën se si ato janë zgjidhur.
- ✓ Në **Bashkinë Berat**, rastet e ankesave i janë përcjellë në masën më të madhe D.R.S.Sh. Vetëm njëra prej përgjigjeve specifikon natyrën e ankesave e cila prek kryesisht rastet e familjeve të varfra që janë përjashtuar nga sistemi i pikëzimit dhe që janë trajtuar me bllok ndihmën 6%. Gjithsesi, përveç kësaj nuk listohen tipologji të tjera ankesash e kështu përgjigjet mbeten në mënyrë të përgjithshme.
- ✓ Në rastin e **Bashkisë Pogradec**, përgjigjet janë të përgjithshme dhe pse ato e orientojnë sistemin e ankimimit drejt njërive qendrore dhe vendore e jo institucioneve të tjera. Po kështu pohohet, pa specifikuar se këto kërkesa janë adresuar por nuk tregohet mënyra se si ato janë zgjidhur.

II. Ofrimi i Ndihmës Ekonomike

Skema e Ndihmës Ekonomike (NE) është instrumenti kryesor për “zbutjen e varfërisë” në vend edhe pse aktualisht ka një ndikim të kufizuar në varfëri. Aktualisht janë rreth 80.000 familje¹ të cilët përfitojnë pagesat e NE. Skema e NE-së shënjestron familjet e varfra, pasi pjesa më e varfër e popullsisë (20% ose kuintili më i varfër i popullsisë në vend, por brenda këtij grupi jo të gjithë mund të konsiderohen të varfër) përfiton 56% të shpenzimeve të skemës.

Treguesit e mbulimit dhe shënjestrimit të familjeve të varfëra nga skema duhet të përmirësohen, përfitimet janë të ulëta dhe administrimi është jo efikas. Skema arrin të mbulojë me pagesa 24.6% të varfërve ekstrem, 19.5% të varfërve total dhe 5.6% e popullsisë jo të varfër arrin të përfitojë këto pagesa.

Pagesa mesatare e tanishme e NE-së është rreth 3.800 – 4.200 lekë në muaj. Kjo do të thotë se pagesa aktualisht ka një ndikim të kufizuar në uljen e varfërisë. Shpenzimet për NE janë rritur në vlerë absolute gjatë dekadës së fundit, por kanë rënë krahasuar me përqindjen që zënë në PBB-së. Po kështu numri i familjeve që marrin NE ka rënë me pothuajse një të tretën (31.6%), me një rënie sidomos në 2014, që korrespondon me reformimin e skemës së Ndihmës Ekonomike në tri rajonet pilot (Tiranë, Elbasan dhe Durrës).

¹ http://www.shendetesia.gov.al/wp-content/uploads/2018/06/Strategjia_Kombetare_per_Mbrojtjen_Sociale_2015-2020.pdf

Aktualisht, pagesat e NE-së kanë një ndikim të kufizuar në varfëri dhe zbutja e varfërisë nuk varet vetëm nga një shënjestrim më efikas. Gjithsesi, masa e pagesës ka pësuar rritje gjatë viteve ku ndër të tjera, rritja indeksohet me inflacionin. Sfidat e mëtejshme të politikës lidhen me rritjen e efikasitetit të skemës së ndihmës ekonomike duke e kthyer nga një skemë pasive në një skemë aktive, nëpërmjet programeve të riintegritimit dhe alternativitetit të tyre me skemat e punësimit.

Sfidë mbetet edhe shtrirja e proceseve të aplikimeve dhe përzgjedhjes së përfituesve nëpërmjet regjistrimit kombëtar dhe formulës së pikëzuar, gjë që do të kërkojë monitorim, raportim dhe përmirësimet e nevojshme të proceseve të punës dhe procedurave, ashtu si dhe përshtatjes sipas karakteristikave të territorit ku do të zbatohen, për të rritur shënjestrimin dhe mbulimin e individëve dhe familjeve më të varfra.

Ndër çështjet që duhen adresuar janë rritja e shënjestrimit të familjeve të varfra dhe ekstremisht të varfra, rritja e mbulimit të tyre nga skema dhe ulja në mënyrë drastike e numrit të përfituesve jo-të varfër.

Duhet të sigurohen aftësitë e nevojshme të personelit përgjegjës në të gjitha nivelet. Zbatimi i skemës së reformuar në nivel lokal dhe kombëtar kërkon një sensibilizim dhe ndërgjegjësim të opinionit publik dhe grupeve të interesit, për të komunikuar në mënyrë të shënjestruar se kush janë qëllimet reale dhe rezultatet e pritshme të reformës. Duhet rritur ndërlidhjet e shërbimeve ndaj përfituesve të Ndhmës Ekonomike, në shëndetësi, arsim, strehim, etj. duke synuar konsolidimin e një pakete të plotë shërbimesh ndaj përfituesve të Ndhmës Ekonomike.

II.1 Analizë e të dhënave të mbledhura nga intervistimi i grupeve në nevojë në lidhje me ndihmën ekonomike

Analizimi i të dhënave të mbledhura nga intervistimi i grupeve në nevojë në gjashtë bashki: **Kukës, Ebasan, Librazhd, Fier, Berat dhe Pogradec** sa i përket monitorimit të shpërndarjes së ndihmës ekonomike nga njësitë e qeverisjes vendore, u realizua përmes pyetësorëve të gjysmë-strukturuar duke synuar mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave cilësore dhe sasore përmes intervistimit të drejtpërdrejtë.

Pyetjet u strukturuan në një mënyrë të tillë për të marrë informacion në lidhje me moshën, gjendjen familjare, informimin në lidhje me skemën e NE, përfitimin në kohë të saj, vështirësitë e hasura, cilësinë e shërbimit, plotësimi i nevojave ekonomike të kësaj skeme etj. Të dhënat e përftuara ndihmojnë në nxjerrjen e konkluzioneve sa i përket monitorimit të shpërndarjes së ndihmës ekonomike, cilësisë së këtij shërbimi, nevojave të qytetarëve pjesë e kësaj skeme si dhe identifikimit të problematikave dhe adresimit adekuat të tyre. Grupet në nevojë të intervistuar në të gjashtë bashkitë janë pjesë e përfitimit nga skema e NE si dhe i përkasin grupmoshave të ndryshme, në pjesën dërrmuese moshës 25-65 vjeç, si dhe në 92 % të tyre jetojnë së bashku me anëtarë të tjerë të familjes.

Nisur nga mënyra e strukturimit të pyetjeve, rezulton se sa i përket informimit nga njësitë e qeverisjes vendore në lidhje me skemen aktuale të NE, qytetarët që i përkasin **bashkisë Elbasan** janë shprehur si më poshtë:

- Shumë të informuar -98% e të intervistuarve;
- Pak të informuar – 2% e të intervistuarve;

Në **bashkinë Librazhd** janë shprehur si vijon:

- Shumë të informuar -32% e të intervistuarve;

- Pak të informuar – 54% e të intervistuarve;
- Aspak të informuar – 14% e të intervistuarve.

Në **bashkinë Kukës:**

- Shumë të informuar -4% e të intervistuarve;
- Pak të informuar – 57% e të intervistuarve;
- Aspak të informuar – 39% e të intervistuarve.

Në **bashkinë Berat:**

- Shumë të informuar -45% e të intervistuarve;
- Pak të informuar – 51% e të intervistuarve;
- Aspak të informuar – 4% e të intervistuarve.

Në **bashkinë Fier:**

- Shumë të informuar -77% e të intervistuarve;
- Pak të informuar – 21% e të intervistuarve;
- Aspak të informuar – 2% e të intervistuarve.

Në **bashkinë Pogradec:**

- Shumë të informuar -98% e të intervistuarve;
- Pak të informuar – 2% e të intervistuarve;

Nga rezultatet e mësipërme vërejmë se qytetarët e Bashkisë Elbasan rezultojnë më të informuar me **98%** e të intervistuarve (shumë të informuar), ndjekur nga **Bashkia Fier me 77%** të qytetarëve shumë të informuar, **Bashkia Pogradec me 70%** e të intervistuarve dhe **Bashkia Berat me 45%** në kategorinë shumë të informuar. **Bashkia Librazhd me 32%** dhe **Bashkia Kukës me 4%**, kanë numrin më të ulët të qytetarëve që janë shumë të informuar në lidhje me skemën e NE. Në konkluzion të këtyre të dhënave rezulton se në **Bashkinë Elbasan** qytetarët përfitues janë më të informuar në lidhje me skemën e NE, ndjekur nga qytetarët në **bashkinë Fier** dhe **Pogradec**, ndërkohë që qytetarët në **Bashkinë Kukës** rezultojnë më të pa informuarit.

Në lidhje me pyetjen nëse e kanë përfituar ndihmën ekonomike në kohë, rezulton se **Bashkia Berat**, në mënyrë unanime (100%) qytetarët shprehen se janë trajtuar në kohën e parashikuar me ndihmën ekonomike, pasuar nga qytetarët e **Bashkisë Fier** me 91% të të intervistuarve duke vijuar më pas me **Bashkinë Elbasan ku 87%** e të intervistuarve japin përgjigje pozitive dhe më pas **Bashkia Pogradec** me 85%. Qytetarët në Bashkinë Librazhd shprehen se 74% e tyre marrin ndihmën ekonomike në kohë dhe 65% e të intervistuarve në Bashkinë Kukës. Ndërkohë, që vetëm 13% e të intervistuarve në Bashkinë Elbasan pretendojnë që nuk kanë përfituar në kohë këto shërbime, ndërsa në Bashkinë Librazhd ky numër shkon në 26% të të intervistuarve dhe në Bashkinë Kukës shkon në 35%. Edhe për këtë pyetje, **Bashkia Berat, Fier, Elbasan dhe Pogradec vlerësohen më pozitivisht krahasuar me Bashkinë Kukës dhe Librazhd**. Të katërta rastet dhe vlerësimet janë pozitive, të cilat tregojnë efincencën e njësive vendore për ta shpërndarë NE në kohë.

Vështirësitë e hasura në procesin e aplikimit për të qenë pjesë e skemës së përfitimit të ndihmës ekonomike, ishte një tjetër pyetje e bërë, nga ku rezultoi përsëri që **Bashkia Elbasan** vlerësohet më pozitivisht nga anketuesit. Më konkretisht, **75%** e të intervistuarve në bashkinë Elbasan rezultojnë se nuk kanë hasur vështirësi në procesin e aplikimit, ndërkohë që në **Bashkinë Kukës** numri i të intervistuarve që shprehin të njëjtin qëndrim shkon në **10%**.




Tabela nr.1: Çfarë vështirësish keni hasur në procesin e aplikimit për të qenë pjesë e skemës së përfitimit të ndihmës ekonomike?

Pyetjes se sa të kënaqur jeni me shërbimin e ofruar nga njësitë e qeverisjes vendore, qytetarët i janë përgjigjur si më poshtë:

- Në **Bashkinë Elbasan:**

Shumë të kënaqur – 96% e të intervistuarve;

Pak të kënaqur – 4% e të intervistuarve;

Aspak të kënaqur – 0% e të intervistuarve.

- Në **bashkinë Librazhd:**

Shumë të kënaqur- 40% e të intervistuarve;

Pak të kënaqur – 44% e të intervistuarve.

Aspak të kënaqur – 16% e të intervistuarve.

- Në **Bashkinë Kukës;**

Shumë të kënaqur- 2% e të intervistuarve;

Pak të kënaqur – 27% e të intervistuarve;

Aspak të kënaqur – 71% e të intervistuarve.

- Në **Bashkinë Pogradec:**

Shumë të kënaqur- 60% e të intervistuarve;

Pak të kënaqur – 30% e të intervistuarve;

Aspak të kënaqur – 10% e të intervistuarve.

- Në **Bashkinë Fier:**

Shumë të kënaqur- 58% e të intervistuarve;

Pak të kënaqur – 28% e të intervistuarve;

Aspak të kënaqur – 14% e të intervistuarve.

- Në **bashkinë Berat:**

Shumë të kënaqur- 29% e të intervistuarve;
Pak të kënaqur – 56% e të intervistuarve;
Aspak të kënaqur – 15% e të intervistuarve.

Përsa i përket mendimit nëse procesi i përzgjedhjes së individëve që përfitojnë ndihmë ekonomike është transparent, i barabartë dhe i bazuar në kritere objektive përzgjedhjeje, anketuesit në bashki të ndryshme kanë mbajtur qëndrime të ndryshme. Në **Bashkinë Elbasan 89%** e të anketuarve shprehen pozitivisht, përkundrejt **69%** e të intervistuarve në **Bashkinë Berat; 46%** të anketuarve në **Bashkinë Librazhd** dhe **6%** në **Bashkinë Kukës**. Ndërkohë, në **Bashkinë Kukës 94%** shprehen negativisht në lidhje me transparencën dhe objektivitetin e përzgjedhjes, përkundrejt **70%** e të intervistuarve në **Bashkinë Pogradec; 58 %** në **Bashkinë Fier** duke u ndjekur nga **Bashkia Librazhd** me 54% të anketuarve dhe 11% në **Bashkinë Elbasan**.

Ajo për të cilën bien dakort në pjesën dërrmuese të tyre, intervistuesit në të gjashta bashkitë ka të bëjë me gjykimin nëse ndihma ekonomike që përfitohet nga skema aktuale plotëson apo jo nevojat e përditshme të përfituesve të ndihmës ekonomike. Në Bashkinë **Kukës, Pogradec** dhe **Berat** 100% e të anketuarve deklarojnë se NE e përfituar nuk plotëson nevojat e përditshme, përkundrejt 96% te anketuarve në **Bashkinë Librazhd** dhe 96% në **Bashkinë Elbasan**. Ndërkohë që vetëm 9% në **Bashkinë Fier** dhe 4% e të anketuarve në **Bashkinë Elbasan** gjykojnë se NE i plotëson nevojat e përditshme, përkundrejt 4% të të anketuarve në **Bashkinë Librazhd**.

Në lidhje me njohuritë mbi mekanizmat e ankimimit për të denoncuar problemet në lidhje me ofrimin e ndihmës ekonomike konstatohen qasje plotësisht të ndryshme, sidomos ndërmjet të anketuarve në Bashkinë Kukës dhe Elbasan. Ndërkohë që në **Bashkinë Kukës 98%** e të anketuarve i përgjigjen negativisht kësaj pyetjeje, në **Bashkinë Elbasan 98%** e të anketuarve shprehen pozitivisht; në **Bashkinë Pogradec 75%** e të anketuarve përgjigjet pozitivisht, ndjekur nga **Bashkia Fier** me 72% dhe **Bashkia Berat** me 67%. Më e ekuilibruar konstatohet situata në **Bashkinë Librazhd** ku 34% e të anketuarve shprehen pozitivisht përkundrejt 66% të tyre të cilët shprehen negativisht.

Pyetjes se nisur nga eksperiencia juaj personale, a ka patur raste të paraqitjes së ankesave në lidhje me skemën e ndihmës ekonomike, dhe nëse po, si e vlerësoni adresimin e tyre nga strukturat përkatëse të njëjsteve të organeve vendore, qytetarët sipas bashkive i janë përgjigjur si më poshtë:

Në **Bashkinë Elbasan:**

- ✓ Shumë mirë – 47% e të intervistuarve;
- ✓ Mirë – 47% e të intervistuarve;
- ✓ Dobët – 6% e të intervistuarve.

Në **bashkinë Librazhd:**

- ✓ Shumë mirë – 15% e të intervistuarve;
- ✓ Mirë – 54% e të intervistuarve;
- ✓ Dobët – 31% e të intervistuarve.

Në **bashkinë Kukës:**

- ✓ Mirë – 31% e të intervistuarve;
- ✓ Dobët – 69% e të intervistuarve.

Në **bashkinë Fier:**

- ✓ Mirë – 47% e të intervistuarve;
- ✓ Dobët – 53% e të intervistuarve.

Në bashkinë Berat:

- ✓ Shumë mirë - 33% e të intervistuarve;
- ✓ Mirë – 36% e të intervistuarve;
- ✓ Dobët – 19% e të intervistuarve.

Në bashkinë Pogradec:

- ✓ Shumë mirë - 5% e të intervistuarve;
- ✓ Mirë – 80% e të intervistuarve;
- ✓ Dobët – 19% e të intervistuarve.

Pra, siç konstatohet edhe për këtë pyetje, Bashkia Elbasan vlerësohet më pozitivisht krahasuar me bashkitë e tjera. Ndërsa, vërejmë që në Bashkinë Fier dhe Kukës, qytetarët nuk janë të kënaqur me adresimin e problematikave nga Njësitë e Qeverisjes Vendore.

II.2 Problematikat e konstatuara dhe rekomandime

Sistemi për përfitimin e ndihmës ekonomike duket se ka krijuar konfuzion dhe shqetësim te madh për qytetarët. Sipas familjeve në nevojë, problemet fillojnë që nga përjashtimi në mënyrë të padrejtë nga ndihma ekonomike deri tek ulja e shumës së parave në shifra qesharake. Për familjet me të ardhura minimale për jetën, ndihma ekonomike është i vetmi burim financiar për të përballuar shpenzimet e jetesës.

Ajo që përbën një problem kryesor dhe lehtësisht të evidentueshëm është se: masa e ndihmës ekonomike është shumë e ulët dhe thuajse e papërfillshme në raport me shpenzimet mujore më të domosdoshme që i duhen familjes, ose një individit të vetëm për të mbijetuar, e jo më pastaj për të konsideruar për dinjitet dhe integritet në shoqëri.

E pajustificueshme për ekzistencën e kësaj gjendje është mos përcaktimi i një minimumi jetik dinjitoz, qoftë edhe brenda mundësive të burimeve të shtetit shqiptar, i cili, pa dyshim, do të plotësonte më mirë nevojat e çdo qytetari në nevojë. Qeveria duhet të programojë më mirë plotësimin e këtyre nevojave në lidhje me vlerën e minimumit jetik.

Nisur dhe nga përgjigjet dhe problematikat e konstatuara nga intervistat e zhvilluara me qytetarët, janë përgatitur **rekomandimet** e mëposhtme:

Për Njësitë e Qeverisjes Vendore Elbasan, Librazhd, Kukës, Fier, Berat dhe Pogradec:

- ✓ Rritjen e informimit dhe ndërgjegjësimin të qytetarëve për kriteret, procedurat dhe plotësimin e dokumentacionit të përfitimit të ndihmës ekonomike.
- ✓ Lehtësimin e procesit të aplikimit për të qenë pjesë e skemës së përfitimit të ndihmës ekonomike përmes rritjes së bashkëpunimit të strukturave vendore me grupet në nevojë.
- ✓ Marrjen e të gjithë hapave dhe procedurave të nevojshme për përfitimin/ofrimin në kohë nga organet e pushtetit vendor të ndihmës ekonomike.
- ✓ Përmirësimin e instrumenteve informues në lidhje me mekanizmat e ankimimit për të denoncuar problemet në lidhje me ofrimin e ndihmës ekonomike.
- ✓ Marrjen e masave për të adresuar në kohë dhe në mënyrën e duhur ankesat e qytetarëve për përfitimin e ndihmës ekonomike.
- ✓ Forcimin dhe rritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore për të verifikuar fizikisht banesat dhe kushtet e jetesës të përfituesve një apo dy herë në vit, siç parashikohet në ligj.

- ✓ Shmangien e rasteve të përjashtimit nga përfitimi i ndihmës ekonomike të familjeve pretenduese, kur familja ka në përbërjen e saj anëtar i cili është person me aftësi të kufizuara.
- ✓ Shpërndarja në kohë e pagesës së ndihmës ekonomike, të përfituesve nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në masën 6%.
- ✓ Ofrimin e shërbimeve shoqërore, të cilat do të rrisin cilësinë e jetës të qytetarëve përfitues të ndihmës ekonomike dhe familjeve të tyre.
- ✓ Mbështetjen dhe orientimin e qytetarëve që janë pjesë e skemës së ndihmës ekonomike për të aplikuar në programet sociale, ku përfituesit e ndihmës ekonomike të përfshihen duke dhënë kontribut me punën e tyre dhe kjo të influencojë në rritjen e të ardhurave të familjeve të tyre.

Për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

- ✓ Rishikimi në tërësi i formularit të aplikimit sipas sistemit të pikëzimit, specifikisht për kategorinë e personave që janë mbi moshë pune dhe nuk janë përfitues të asnjë lloj pensioni pleqërie (mosha 60-70).
- ✓ Rritjen e transparencës, barazisë dhe përcaktimin e kriterëve objektive të përzgjedhjes për individët që përfitojnë ndihmë ekonomike.
- ✓ Nevojën për rritjen e shumës së përfituar të ndihmës ekonomike për të përballuar shpenzimet mujore më të domosdoshme që i duhen familjes, ose një individ të vetëm për të mbijetuar.

Për Ministrinë e Financës dhe Ekonomisë

- ✓ Nevojën për ofrimin e kurseve të formimit profesional në përputhje me kërkesat e tregut të punës për personat që janë pjesë e skemës së ndihmës ekonomike dhe përmirësimi i cilësisë së tyre.

III. Respektimi i të drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuar

Pagesa e Aftësisë së Kufizuar (PAK) është pjesë e programit të Mbrojtjes Sociale dhe shërben për të mbështetur njerëzit me aftësi të kufizuara dhe përmirësuar cilësinë e jetesës. Shpenzimet për pagesat e aftësisë së kufizuar janë rritur ndjeshëm në vitet e fundit dhe tashmë përbëjnë pjesën kryesore në shpenzimet e Mbrojtjes Sociale.

Numri i personave që marrin pagesën e aftësisë së kufizuar është rritur me gati dy të tretat (63.7%) në mbi 160.000². Edhe pse kjo skemë nuk ka qartësisht objekt shtresat e varfra, në praktikë kuintili më i varfër i popullsisë merr 39% të shpenzimeve për aftësinë e kufizuar. Megjithatë, si në shumë vende në tranzicion, ekzistojnë disa çështje serioze në lidhje me funksionimin e skemës së aftësisë së kufizuar. Sistemi i vlerësimit është i bazuar thjesht në analiza mjekësore dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht peshën e aftësisë së kufizuar apo dëmtimit funksional bazuar në standardet e Klasifikimit Ndërkombëtar Funksional dhe Shëndetësor (ICF) 16.

² http://differentandequal.org/wp-content/uploads/2016/10/Strategjia_Kombetare_e_Mbrojtjes_Sociale1.pdf

III.1 Analizë e të dhënave të mbledhura nga intervistimi i grupeve në nevojë që i përkasin Personave me Aftësi të Kufizuara (PAK)

Analizimi i të dhënave të mbledhura nga intervistimi i grupeve në nevojë në gjashtë bashki: **Kukës, Elbasan, Librazhd, Fier, Berat dhe Pogradec** sa i përket monitorimit të shërbimeve sociale të ofruara nga njësitë e qeverisjes vendore për personat me aftësi të kufizuara, u realizua gjithashtu përmes pyetësorëve të gjysmë-strukturuar duke synuar mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave cilësore dhe sasore përmes intervistimit të drejtpërdrejtë.

Pyetjet u strukturuan në një mënyrë të tillë për të marrë informacion në lidhje me moshën, gjendjen familjare, informimin në lidhje me shërbimet sociale për personat me aftësi të kufizuara, zbatimin e ligjit për punësimin e PAK, infrastrukturën e nevojshme, rimbursimin e transportit/karburantit, çështjet e diskriminimit, skemën e pagesës, përfitim të saj në kohë, procesin e përzgjedhjes etj. Grupet që i përkasin personave me aftësi të kufizuara të intervistuar në të gjashtë bashkitë janë pjesë e përfitimit të skemës si personave me aftësi të kufizuara si dhe i përkasin grupmoshave të ndryshme, në pjesën dërrmuese të moshës **18-65 vjeç**, si dhe në **98 %** të tyre jetojnë së bashku me anëtarë të tjerë të familjes.

Nisur nga mënyra e strukturimit të pyetjeve, rezulton se sa i përket informimit në lidhje me shërbimet sociale që ofrohen nga njësitë e qeverisjes vendore për personat me aftësi të kufizuara, 93% të qytetarëve që i përkasin **Bashkisë Elbasan** përgjigjen pozitivisht, ndjekur nga **Bashkia Pogradec** me 82% e të intervistuarve; **Bashkia Fier** dhe **Librazhd** me 75% e të intervistuarve dhe 71% e të intervistuarve. Duke vijuar me **bashkinë Berat** me 66% dhe **bashkinë Kukës** me 36% e të intervistuarve.

Ndërkohë, negativisht kësaj pyetje i janë përgjigjur si më poshtë:

- 34% e të intervistuarve në **Bashkinë Berat**;
- 32% të të intervistuarve në **Bashkinë Kukës**;
- 25% e të intervistuarve në **Bashkinë Fier**;
- 18% e të intervistuarve në **Bashkinë Pogradec**;
- 7% të të intervistuarve në **bashkinë Elbasan**;
- 2% të të intervistuarve në **Bashkinë Librazhd**.

Nga përgjigjet e dhëna, rezulton se në **Bashkinë Elbasan dhe Pogradec** qytetarët përfitues janë më të informuar në lidhje me shërbimet sociale që ofrohen për personat me aftësi të kufizuara, ndërkohë që qytetarët në **Bashkinë Librazhd** rezultojnë më të pa informuar.

Në lidhje me pyetjen për zbatimin e ligjit “*Për nxitjen e punësimit*”, nëse ky ligj zbatohet për personat me aftësi të kufizuara dhe se a janë ndjerë ndonjëherë të diskriminuar nga punëdhënësit për shkak të paaftësisë së tyre fizike, rezulton se vetëm **një prej të intervistuarve (nga 35 gjithsej)** nga qytetarët në **Bashkinë Elbasan** deklaroi që është ndjerë i diskriminuar, ndërkohë që qytetarët e tjerë deklarojnë që nuk janë ndjerë të tillë apo që nuk kanë aplikuar për punë. Ndërkohë, në **Bashkinë Librazhd** rreth **24 qytetarë (nga 51 të intervistuar)** deklarojnë se janë ndjerë të diskriminuar kur kanë kërkuar punë, ndërkohë që pjesa tjetër deklaroi se nuk janë ndjerë të tillë apo që nuk kanë dijeni për ligjin. Në **Bashkinë Kukës**, ashtu si dhe në Bashkinë Elbasan rezulton se vetëm **një prej të intervistuarve (nga 49 gjithsej)** deklaroi që është ndjerë i diskriminuar, ndërkohë që qytetarët e tjerë deklaroi që nuk janë ndjerë të tillë apo që nuk kanë informacion

për ligjin. Ajo që bie në sy në Fier dhe në Pogradec është se të intervistuarit deklarojnë, se kanë njohuri të pjesshme për ligjin, e kështu në **Bashkinë Fier** (12 nga 51 të intervistuar), kurse në **Bashkinë Pogradec** 15 (nga 22) shprehen se e njohin ligjin. Informacion më të plotë për këtë kanë qytetarët në **Bashkinë e Beratit** ku 21 nga 50 të intervistuar deklarojnë se e njohin ligjin por njëkohësisht shprehen shumë skeptikë për zbatimin e tij. Ato thonë se ligji është aspak ose pak i zbatueshëm.

Në raport me diskriminimin në **Bashkinë Fier** 13 persona (nga 57 të intervistuar) deklarojnë se janë ndjerë të diskriminuar, ndërkohë që të tjerët shprehen negativisht për këtë. Në **Bashkinë Pogradec**, vetëm 2 persona shprehen se janë diskriminuar kur kanë kërkuar punë (nga 22 të intervistuar). Në **Bashkinë Berat** 32 nga 50 persona të intervistuar ndjehen të diskriminuar kur kanë aplikuar apo aplikojnë në punë. Diskriminimi ndjehet rëndom në raport me PAK, dhe kur këta kanë dijeni për ligjin e konsiderojnë atë të pazbatueshëm.

Përsa i përket ekzistencës së infrastrukturës së nevojshme për të përfituar nga shërbimet publike/sociale (rampa për karrocet, ashensorë në godina etj), qytetarët janë përgjigjur si më poshtë:

Në **Bashkinë Elbasan**:

- 74% e të intervistuarve i janë përgjigjur pozitivisht;
- 8% e të intervistuarve i janë përgjigjur negativisht;
- 18% e të intervistuarve i janë përgjigjur se infrastruktura ekziston pjesërisht.

Në **bashkinë Librazhd**:

- 12% e të intervistuarve i janë përgjigjur pozitivisht;
- 51% e të intervistuarve i janë përgjigjur negativisht;
- 37% e të intervistuarve i janë përgjigjur se infrastruktura ekziston pjesërisht.

Në **bashkinë Kukës**:

- 4% e të intervistuarve i janë përgjigjur pozitivisht;
- 61% e të intervistuarve i janë përgjigjur negativisht;
- 35% e të intervistuarve i janë përgjigjur se infrastruktura ekziston pjesërisht.

Në **bashkinë Berat**:

- 46% e të intervistuarve i janë përgjigjur negativisht;
- 54% e të intervistuarve i janë përgjigjur se infrastruktura ekziston pjesërisht.

Në **bashkinë Pogradec**:

- 14% e të intervistuarve i janë përgjigjur negativisht;
- 86% e të intervistuarve i janë përgjigjur se infrastruktura ekziston pjesërisht.

Në **bashkinë Fier**:

- 17% e të intervistuarve i janë përgjigjur pozitivisht;
- 29% e të intervistuarve i janë përgjigjur negativisht;
- 54% e të intervistuarve i janë përgjigjur se infrastruktura ekziston pjesërisht.

Siç konstatohet nga përgjigjet e dhëna, **Bashkia Elbasan** vlerësohet më pozitivisht në lidhje me ekzistencën e infrastrukturës së nevojshme për personat me aftësi të kufizuara, ndërkohë që **Bashkia Pogradec, Berat dhe Kukës** konsiderohen si më problematike në këtë drejtim.

Përfitimi i rimbursimit të biletës së transportit publik/karburantit ishte një tjetër pyetje e bërë, nga ku rezultoi se vetëm **10%** e të intervistuarve në **Bashkinë Elbasan** i përgjigjen pozitivisht kësaj pyetje, ndjekur nga **Bashkia Librazhd** me **8%**. Ndërkohë që kësaj pyetje të gjithë të intervistuarit në **Bashkinë Kukës** i përgjigjen negativisht, ndjekur nga **Bashkia Librazhd** me **92%** dhe **Bashkia Elbasan** me **90%** të të intervistuarve. Nga vlerësimi i përgjigjeve të dhëna rezulton se,

në të tre bashkitë qytetarët e intervistuar në pjesën dërrmuese të tyre nuk e përfitojnë rimbursimin e biletës së transportit publik/karburantit. Ndërsa në **Bashkitë Fier, Berat dhe Pogradec** situata është krejtësisht ndryshe, pasi të gjithë qytetarët i janë përgjigjur se përfitojnë nga skema e rimbursimit të biletave të transportit publik.

Në lidhje me pyetjen se a jeni ndjerë të diskriminuar për shkak të aftësisë së kufizuar gjatë aplikimeve për punësim, rezulton se në **Bashkinë Librazhd dhe Berat** me përkatësisht 49% e të intervistuarve dhe 34% e tyre deklarojnë se janë ndjerë të diskriminuar, ndjekur nga **Bashkia Pogradec dhe Kukës** me 23% dhe 22%; duke vijuar në **Bashkinë Fier** me 21% dhe **Bashkia Elbasan** me vetëm 2% të të intervistuarve. Përgjigje negative (pra që sjanë ndjerë të tillë) japin **98%** e të intervistuarve në **Bashkinë Elbasan**, ndjekur nga **Bashkia Kukës dhe Pogradec** me 78% dhe 64% duke vijuar me **Bashkinë Fier** me **56%** e qytetarëve, **Bashkia Berat** me **24%** dhe **Bashkia Librazhd** me **22%**. Ndërkohë, në këtë të fundit **29%** e të intervistuarve deklarojnë se janë ndjerë *ndonjëherë* të diskriminuar gjatë aplikimit për punësim. Në **Bashkinë Berat**, evidentohet se **42%** e personave PAK e ndjejnë veten *ndonjëherë* të diskriminuar kur aplikojnë për punë.

Nga krahasimi i të dhënave rezulton se në Bashkinë Elbasan të intervistuarit që i përkasin personave me aftësi të kufizuara ndjehen shumë më pak të diskriminuar, ndërkohë që më shumë të diskriminuar për shkak të aftësisë së kufizuar gjatë aplikimeve për punësim ndjehen qytetarët në Bashkinë Librazhd dhe Berat.

Pyetjes se sa të informuar janë mbi skemën aktuale të ofrimit të pagesës për aftësinë e kufizuar nga organet e pushtetit vendor, qytetarët i janë përgjigjur si në tabelën më poshtë:




Tabela nr:2. Sa të informuar janë mbi skemën aktuale të ofrimit të pagesës për aftësinë e kufizuar nga organet e qeverisjes vendore?

Siç kuptohet dhe nga të dhënat e paraqitura, qytetarët që i përkasin **Bashkisë Elbasan** janë në pjesën dërrmuese të tyre të informuar nga organet e qeverisjes vendore në lidhje me skemën e ofrimit të pagesës për aftësinë e kufizuar ndërkohë që në bashkitë e tjera niveli i informimit është pak a shumë në të njëjtat nivele.

Prej sa kohësh janë pjesë e skemës së pagesës për aftësinë e kufizuar ishte një pyetje tjetër për të intervistuarit në të gjashta bashkitë, nga ku rezultoi se:

Në **Bashkinë Elbasan:**

- ✓ 4% e të intervistuarve janë pjesë e skemës prej 1-6 muaj;
- ✓ 20% e të intervistuarve janë pjesë e skemës prej 6-12 muaj;
- ✓ 76% e të intervistuarve janë pjesë e skemës mbi 12 muaj.

Në **Bashkinë Librazhd:**

- ✓ 24% e të intervistuarve janë pjesë e skemës prej 6-12 muajsh;
- ✓ 76% e të intervistuarve janë pjesë e skemës mbi 12 muaj.

Në **Bashkinë Kukës:**

- ✓ 2% e të intervistuarve janë pjesë e skemës prej 6-12 muajsh;
- ✓ 98 % e të intervistuarve janë pjesë e skemës mbi 12 muaj.

Në **Bashkinë Berat:**

- ✓ 6% e të intervistuarve janë pjesë e skemës prej 1-6 muaj;
- ✓ 22% e të intervistuarve janë pjesë e skemës prej 6-12 muaj;
- ✓ 74% e të intervistuarve janë pjesë e skemës mbi 12 muaj.

Në **Bashkinë Fier:**

- ✓ 8% e të intervistuarve janë pjesë e skemës prej 1-6 muaj;
- ✓ 27% e të intervistuarve janë pjesë e skemës prej 6-12 muaj;
- ✓ 65% e të intervistuarve janë pjesë e skemës mbi 12 muaj.

Në **bashkinë Pogradec:**

- ✓ 23% e të intervistuarve janë pjesë e skemës prej 6-12 muaj;
- ✓ 77% e të intervistuarve janë pjesë e skemës mbi 12 muaj.

Një pyetje tjetër lidhej me përfitimin e pagesës për aftësinë e kufizuar në kohë, qytetarët që e kanë përfituar në kohë pagesën u përgjigjën në këtë mënyrë:

- 98% e të intervistuarve në **Bashkinë Berat;**
- 96% e të intervistuarve në **Bashkinë Fier;**
- 95% e të intervistuarve në **Bashkinë Pogradec;**
- 94% e të intervistuarve në **Bashkinë Elbasan;**
- 73% e të intervistuarve në **Bashkia Librazhd**
- 40% e të intervistuarve në **Bashkia Kukës.**

Qytetarët që nuk e përfitojnë në kohë pagesën për aftësinë e kufizuar janë përgjigjur si më poshtë:

- 60% e të intervistuarvë në **Bashkinë Kukës;**
- 27% e të intervistuarvë në **bashkinë Librazhd;**
- 6% e të intervistuarvë në **Bashkinë Elbasan;**
- 5% e të intervistuarvë në **Bashkinë Pogradec;**
- 4% e të intervistuarvë në **Bashkinë Fier;**
- 2% e të intervistuarvë në **Bashkinë Berat.**

Siç rezulton nga përgjigjet, **Bashkia Berat, Fier, Pogradec dhe Elbasan** vlerësohen pozitivisht si një strukturë që ofron në kohë për përfituesit pagesën e aftësisë së kufizuar, ndërkohë që **Bashkia Kukës** rankohet në fund si një bashki problematike në ofrimin në kohë të kësaj pagese.

Vlerësohet si një pyetje shumë e rëndësishme gjykimi i të intervistuarve në lidhje me faktin nëse pagesa për aftësinë e kufizuar që përfitohet nga skema aktuale plotëson apo jo nevojat e tyre të përditshme. Për këtë pyetje të rëndësishme, shumica dërrmuese e të intervistuarve në të gjashta bashkitë i përgjigjen në të njëjtën mënyrë: **nuk plotëson nevojat e përditshme.** Më konkretisht, **100%** e të intervistuarve në **Bashkinë Kukës, Fier, Berat dhe Pogradec** përgjigjen se kjo pagesë e ofruar nuk plotëson nevojat e tyre, ndjekur nga **Bashkia Librazhd me 96%** dhe **Bashkia Elbasan me 90%** të të intervistuarve. Ndërkohë, **10%** e të intervistuarve në **Bashkinë Elbasan** shprehen pozitivisht (pra kjo pagesë plotëson nevojat e tyre), ndjekur nga **Bashkia Librazhd me 4%** të të intervistuarve.

Në lidhje me vështirësitë e hasura për të qenë pjesë e skemës së pagesës për aftësinë e kufizuar, të intervistuarit në të gjashta bashkitë u përgjigjen si në tabelën më poshtë:




Tabela nr.3: Cfarë vështirësish keni hasur për të qenë pjesë e skemës së pagesës për aftësinë e kufizuar?

Si konkluzion të përgjigjeve të përfuara nga kjo pyetje, rezulton për të gjashta bashkitë se problematika më e madhe për të qenë pjesë e skemës së pagesës për aftësinë e kufizuar lidhet me vështirësitë në përmbushjen e dokumentacionit të kërkuar.

Pyetjes se a janë të kënaqur me shërbimin e ofruar nga organet e qeverisjes vendore, qytetarët i janë përgjigjur si më poshtë:

Në Bashkinë Elbasan:

- Shumë të kënaqur– 92% e qytetarëve;
- Pak të kënaqur – 6% e qytetarëve ;
- Aspak të kënaqur – 2% e qytetarëve.

Në Bashkinë Librazhd:

- Shumë të kënaqur– 18% e qytetarëve;

- Pak të kënaqur – 74% e qytetarëve ;
- Aspak të kënaqur – 8% e qytetarëve.

Në **Bashkinë Kukës:**

- Shumë të kënaqur– 2% e qytetarëve;
- Pak të kënaqur – 45% e qytetarëve ;
- Aspak të kënaqur – 53% e qytetarëve.

Në **Bashkinë Fier:**

- Shumë të kënaqur– 50% e qytetarëve;
- Pak të kënaqur – 38% e qytetarëve ;
- Aspak të kënaqur – 12% e qytetarëve.

Në **Bashkinë Berat:**

- Shumë të kënaqur– 26% e qytetarëve;
- Pak të kënaqur – 68% e qytetarëve ;
- Aspak të kënaqur – 6% e qytetarëve.

Në **Bashkinë Pogradec:**

- Shumë të kënaqur– 41% e qytetarëve;
- Pak të kënaqur – 59% e qytetarëve ;

Edhe për këtë pyetje rezulton se **Bashkia Elbasan** është më e vlerësuar nga qytetarët për shërbimet e ofruara, ndërkohë që **Bashkia Kukës** vlerësohet më problematike ku qytetarët e intervistuar në pjesën dërrmuese të tyre janë pak ose aspak të kënaqur në lidhje cilësinë e shërbimit të ofruar.

Përsa i përket faktin nëse procesi i përzgjedhjes së individëve që përfitojnë pagesën për aftësinë e kufizuar është transparent, i barabartë dhe i bazuar në kritere objektive përzgjedhjeje, qytetarët janë shprehur si më poshtë:




Tabela nr. 4: A mendoni ju që procesi i përzgjedhjes së individëve që përfitojnë pagesën për aftësinë e kufizuar është transparent, i barabartë dhe i bazuar në kritere objektive përzgjedhjeje?

Pra, ashtu si dhe në përgjigjet e pyetjeve të tjera, **Bashkia Elbasan** vlerësohet më shumë nga të intervistuarit ndërkohë që **Bashkia Kukës, Fier dhe Berat** vlerësohen më negativisht sa i përket transparencës dhe kritereve objektive të përzgjedhjes.

Pyetjes, nëse janë përfitues të shtesës në pensionin e invaliditetit, si përftim paaftësie, qytetarët në të gjashta bashkitë janë përgjigjur si më poshtë:

Në **Bashkinë Elbasan:**

- 4% e qytetarëve përfitojnë shtesë në pensionin e invaliditetit;
- 83% e qytetarëve nuk përfitojnë shtesë ne pensionin e invaliditetit;
- 13% e tyre nuk e dine.

Në **Bashkinë Librazhd:**

- 33% e qytetarëve përfitojnë shtesë në pensionin e invaliditetit;
- 47% e qytetarëve nuk përfitojnë shtesë ne pensionin e invaliditetit;
- 20% e tyre nuk e dinë.

Në **Bashkinë Kukës:**

- 22% e qytetarëve përfitojnë shtesë në pensionin e invaliditetit;
- 58% e qytetarëve nuk përfitojnë shtesë ne pensionin e invaliditetit;
- 20% e tyre nuk e dinë.

Në **Bashkinë Fier:**

- 35% e qytetarëve përfitojnë shtesë në pensionin e invaliditetit;
- 65% e qytetarëve nuk përfitojnë shtesë ne pensionin e invaliditetit;

Në **Bashkinë Berat:**

- 62% e qytetarëve përfitojnë shtesë në pensionin e invaliditetit;
- 38% e qytetarëve nuk përfitojnë shtesë ne pensionin e invaliditetit;

Në **Bashkinë Pogradec:**

- 63% e qytetarëve përfitojnë shtesë në pensionin e invaliditetit;
- 37% e qytetarëve nuk përfitojnë shtesë ne pensionin e invaliditetit;

Ajo çfarë reflektohet nga përgjigjet e dhëna është se shumica e të intervistuarve në të gjashta bashkitë në fjalë nuk janë përfitues të shtesës në pensionin e invaliditetit, si përftim paaftësie.

Ndërkohë, pyetjes se a janë hasur vonesa në dhënien e këtij përfitimi, **65%** e të intervistuarve në **Bashkinë Elbasan** deklarojnë se nuk kanë hasur vonesa, ndjekur nga **Bashkia Kukës me 55%** në dhe **Bashkinë Librazhd me 41% të të intervistuarve**. Ndërkohë, që **59%** e të intervistuarve në **Bashkinë Librazhd** deklarojnë se kanë hasur vonesa, ndjekur nga **12%** në **Bashkinë Kukës** dhe vetëm **2%** në **Bashkinë Elbasan**. Një pjesë e të intervistuarve deklarojnë, gjithashtu, që një pjesë e tyre nuk e përfitojnë (33% e tyre në Bashkinë Kukës dhe 33% në Bashkinë Elbasan). Nga ballafaqimi i të dhënave më sipër rezulton se **Bashkia Elbasan** është më pozitive në këtë drejtim ndërkohë që **Bashkia Librazhd** është më problematikja sa i përket vonesave në dhënien e këtij përfitimi.

Ndërsa në **bashkinë Fier, Berat dhe Pogradec** përgjithsisht deklarohet se ky komponent është shpërndarë në kohën e parashikuar. Kjo vihet re sidomos në rastin e **Bashkive Pogradec e Berat**, ku **71%** respektivisht deklarojnë se e kanë marrë atë në kohë, ndërsa në **Bashkinë Fier** kjo përqindje është pak më e ulët, **33%**.

Pyetjes së fundit nëse për problematikën e hasura a janë ankuar tek NJQV dhe si vlerësohet trajtimi i këtyre problematikave nga këto struktura, të intervistuarit që janë ankuar pranë NJQV janë përgjigjur në këtë mënyrë:

- **73%** e të intervistuarve në **Bashkinë Pogradec;**
- **71%** e të intervistuarve në **Bashkinë Fier;**
- **61%** e të intervistuarve në **Bashkinë Elbasan;**
- **56%** e të intervistuarve në **Bashkinë Berat**
- **47%** e të intervistuarve në **Bashkinë Kukës;**
- **29%** e të intervistuarve në **Bashkinë Librazhd.**

Ndërkohë, qytetarët që nuk janë ankuar pranë NJQV janë përgjigjur si më poshtë:

- 71% e të intervistuarve në **Bashkinë Librazhd;**
- 53% e të intervistuarve në **Bashkinë Kukës;**
- 44% e të intervistuarve në **bashkinë Berat;**
- 39% e të intervistuarve në **Bashkinë Elbasan;**
- 29% e të intervistuarve në **bashkinë Fier;**
- 27% e të intervistuarve në **bashkinë Pogradec.**

Në lidhje me trajtimin e këtyre problematikave nga strukturat e NJQV, qytetarët i janë përgjigjur si në tabelën që vijon:




Tabela nr.5: Si e vlerësoni trajtimin e problematikës nga strukturat përkatëse të NJQV

Nga ballafaqimi i këtyre të dhënave rezulton se, mënyra e trajtimit të problematikave të qytetarëve të kësaj kategorie nga Bashkia Elbasan, Kukës dhe Librazhd lë më shumë për të dëshiruar krahasuar me trajtimin e tyre nga Bashkia Fier, Berat dhe Pogradec.

III.2 Problematikat e konstatuara dhe rekomandime

Sfidat e mëtejshme të politikës lidhen me vlerësimin e kritereve të aftësisë së kufizuar, rishikimin e masës së pagesave të aftësisë së kufizuar në përputhje me standardet bashkëkohore evropiane dhe ri-integrimin e PAK me shërbimet sociale dhe shëndetësore. Procedurat dhe proceset duhet të

automatizohen në masën më të madhe të mundshme dhe duhet të synohet një proces i drejtë dhe transparent, ashtu siç duhet të mundësohet ulja e rasteve të abuzimeve.

Institucionet përgjegjëse duhet të krijojnë një dialog të vazhdueshëm ndërmjet zyrave përgjegjëse për shërbimet shoqërore dhe atyre për shërbimet e punësimit, për rritjen e hapësirave për ri-integrimin në punë të personave me aftësi të kufizuar.

Bazuar në nevojat reale të personave me aftësi të kufizuar, vlerësimi bio-psiko-social të gjendjes së tyre, sfidë mbetet strukturimi më i përshtatshëm i pagesave të aftësisë së kufizuar ashtu si dhe integrimi i tyre me shërbimet shoqërore, me synim plotësimin në masën më të madhe të nevojave të tyre.

Nisur dhe nga përgjigjet dhe problematikat e konstatuara nga intervistat e zhvilluara me qytetarët, janë përgatitur **rekomandimet** e mëposhtme:

Për Njësitë e Qeverisjes Vendore Elbasan, Librazhd, Kukës, Fier, Berat dhe Pogradec:

- ✓ Rritjen e informimit dhe ndërgjegjësimi në lidhje me shërbimet sociale që ofrohen nga njësitë e qeverisjes vendore për personat me aftësi të kufizuar.
- ✓ Marrjen e të gjithë hapave dhe procedurave të nevojshme për përfitimin/ofrimin në kohë nga organet e pushtetit vendor të pagesës për aftësinë e kufizuar dhe të pagesës si përfitim paaftësie, shtesë në pensionin e invaliditetit.
- ✓ Lehtësimin e procesit të aplikimit për të qenë pjesë e skemës së përfitimit të pagesës së aftësisë së kufizuar përmes rritjes së bashkëpunimit të strukturave vendore me grupet që i përkasin kësaj kategorie.
- ✓ Realizimin e plotë të përshtatshmërisë ndërtimore për personat me aftësi të kufizuara (Infrastruktura rrugore duhet të jetë e përshtatur, me qëllim që të sigurojë lëvizje të pavarur për ta: sinjalistikën rrugore të perceptueshme nga personat me probleme shikimi, transport publik të aksesueshëm, institucione arsimore të përshtatura dhe të aksesueshëm, qendra rehabilitimi etj, të cilat do të ofronin mundësi të barabarta për të gjithë qytetarët).
- ✓ Ofrimin e aksesit në transportin urban publik dhe rimbursimin e biletës.
- ✓ Ofrimin e informacionit të nevojshëm në lidhje me dispozitat ligjore për punësimin e personave me aftësi të kufizuar.

Për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

- ✓ Nevojën për rritjen e shumës së përfituar nga pagesa për aftësinë e kufizuar, për të përballuar plotësimin e nevojave të përditshme që i duhet një individ me aftësi të kufizuar.
- ✓ Rritjen e transparencës, barazisë dhe përcaktimin e kritereve objektive të përzgjedhjes për individët që përfitojnë pagesën për aftësinë e kufizuar.
- ✓ Marrjen e të gjithë hapave dhe procedurave të nevojshme për përfitimin e paketës higjieno-sanitare të personave që përfitojnë pagesën e aftësisë së kufizuar dhe invalidëve të punës. (Sipas legjislacionit në fuqi, vetëm invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë përfitojnë një pagesë shtesë, për mbulimin e paketës së domosdoshme me materiale të veçanta higjieno-sanitare).

Për Ministrinë e Financës dhe Ekonomisë

- ✓ Dhënien e të drejtës për të përfituar rimbursimin për shpenzimet në blerjen e karburantit dhe vajit lubrifikant. (Ligjet specifike për personat që gëzojnë statusin e invalidit të punës, të invalidit paraplegjik e tetraplegjik dhe statusin e të verbërit³, i japin të drejtën këtyre kategorive për të përfituar rimbursimin e shpenzimeve për blerjen e karburanteve dhe të lubrifikanteve për mjetet motorrike në përdorim të përshtatura për ta).

³ Ligji nr.8098/28.03.1996 “Për statusin e të verbërit”, i ndryshuar
Ligji nr.8626/22.06.2000 “Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, i ndryshuar
Ligji nr.7995/20.09.1995 “Për statusin e invalidëve të punës”, i ndryshuar